

BIBLIOTEKA
E


884-92
T 95

SHTETIT

GJIROKASTER

TUT

KRISTAQ



85H-32

KRISTAQ TUTULANI

T95

SHKRIME
TË
ZGJEDHURA

~~SHTEPIA E SHTETIT~~
~~ZGJEDHURAT~~

~~37312~~ 3278



KRISTAQ TUTULANI

D Y F J A L E

Udhëtari që shkon nga Durrësi pér në Rrogozhinë, pak më tej, pasi lë fermën e Gosës, në të majtë të rrugës, shikon një përmendore me këtë mbishkrim: «Margarita e Kristaq Tutulani, vrarë nga fashistët më 6 korrik 1943». Aty, vëlla e motër, të dy komunistë, të dy anëtarë të Komitetit Qarkor të Partisë Komuniste në Berat, puthën së bashku tokën amtare, pér çlirimin e së cilës dhanë pranverën e jetës së tyre.

Kristaqi lindi më 7 dhjetor 1919 në Berat. Ai nuk kishte mbushur 24 vjeç, kur u pushkatua barbarisht nga agjentët e S.I.M.I.-it në korrik 1943.

Shkollën e mesme e filloi në qytetësen e Beratit, e vazhdoi në Liceun e Korçës (nga u përjashtua pér pjésëmarrje në demonstratën antifashiste të 28 nëndorit 1939) dhe e mori maturën në gjimnazin e Shkodrës. Në kujtimet e shokëve të tij thuhet se në një takim t'organizuar nga maturantët e kësaj shkolle në vitin 1941, një profesori të ri që po e cilësonte N. Frashërin si poet arkaik e bejtexhi, Kristaqi, me atë zërin e tij tingëllues e plot revoltë, iu përgjigj: «ju, zoti profesor, posa keni mbaruar universitetin në Itali dhe kini nevojë të madhe të njihni e të vlerësoni si duhet literaturën e poetët e vendit tonë».

Ai i braktisi shpejt studimet e larta që kishte filluar në Itali, ku merrte pjesë aktivisht në rrethet studenteske antifashiste. Në vitin 1942, ndodhej në Berat, ku qendronte në radhët e para të komunisteve. I pa-përtuar, i përpiktë, i sjellshëm e i gatshëm në çdo kohë, Kristaqi që i gatshëm kurdoherë të kryente detyrat e

organizatës së Partisë. Për aktivitetin e tij u zgjodh delegat në konferencën e parë të Partisë për Qarkun e Beratit, e cila i besoi detyrën e antarit të Komitetit Qarkor. Në Komitet u ngarkua me përgjegjësinë e agit-propit. Kristaqi dinte të shpinte në radhët e rinisë, në radhët e popullit, vijën revolucionare të Partisë t'argumentuar e të zbirrhyer drejt. Me dorën e tij hartoï kaq thirrje e komunikata që dalloheshin për forcën dhe qartësinë politike, për zjarrin patriotik dhe optimizmin në fitoren e revolucionit. Ai ish gati të hynte në debat me cilindo për të provuar forcën dhe vërtetësinë e ideve, për të cilat militonte. Kristaqi kishte bindje të thellë në triumfin e luftës N. Çlirimtare, besim të patundur te Partia e re e komunistëve shqiptarë, te drejtësia dhe triumfi i komunizmit. Këtë bindje ai nuk e sillte nga klasa, së cilës i përkiste, por nga vëzhgimet e tij të thella rrëth botës së varfër që ndeshtë porsa dilte nga pragu i shtëpisë, nga pragu i qytetit të vendlindjes, nga një vështrim objektiv dhe realist që u bënte ngjarjeve politike dhe shoqërore jo vetëm brenda, por edhe jashtë kuadrit shqiptar.

Që kur ishte ende mjaft i ri, me një shpirt poetik të ndjeshëm, nisi provat e para në fushën e letërsisë. Veprimitarinë letrare e filloi në vitet 1930. Shkrimet e para ishin shkrime fëminie që sigurisht kishin dobësitet e tyre artistike, por që, edhe pse me të meta, dëshmonin për një fillestar me talent, që prekte probleme të mëdha.

Tematika e krijimit letrar të Kristaq Tutulanit është e gjërë dhe interesante, po të marrim parasysh moshën, pjekurinë letrare dhe kohën e shkurtër që shkroi ai. Në shkrimet e tij gjen mall e dashuri për tokën amtare, për popullin që vuani, për të varfërin, për traditat liridashëse të të parëve tanë. Dashuria e tij për Atdhenë e popullin nuk qe një dashuri abstrakte e sentimentale. Ende mjaft i ri ai dijti të vërejë se në Shqipëri kishte të pasur e të varfër, shfrytëzues e të çfrytëzuar. Ai përshkruan jetën e rëndë, mjerimin e grave të varfëra që rropaten tërë ditën duke mbledhur ullinj, «12 orë

të gjata midis sa e sa të këqiave për dy lekë të shkretë». Shumë lutje i drejtohen zotit, por ai s'përgjigjet për padrejtësitë e kësaj bote» e kudo «i pafajshëm vuan, kurse sa e sa fajtorë rrojnë të lumtur». E jo vetëm që jep disa pamje të mjerimit të njerëzve të thjeshtë, jo vetëm që qesëndis besimin në perëndinë (Provë perëndije? !... Pallavra të kota!), por shkon edhe më larg, hedh shikimin në një botë të re t'ardhshme:

Njeri mos beso
se ka paqë sot
e shpërblime mot;
Botë të re kërko.

E do të jetë pikërisht kërkimi i kësaj bote të re një ndër faktorët përcaktues që do ta shtyjë Kristaq Tutulanin, pak vjet më vonë, të përqafojë pa ngurim çesh-tjen e Partisë e të bëhet një militant i çquar i saj.

E tamam n'ato vite stuhije ai shënon skemën e një romani në tri pjesë kryesore që do të përbënte ndoshta krijuimtarinë e tij më të bukur.

Të gjitha këto tregojnë se Kristaq Tutulani, me gjithse më i ri në moshë, ishte bashkëluftar i lshkrimtarëve të rinj përparimtarë të viteve 30, i Migjenit me shokë, që krijuan një letërsi realiste me problematikë shoqërore, një letërsi që jo vetëm përshkruante jetën e rëndë të masave punonjëse, po që kërkonte të ngrinte mbi rrënimet e botës së vjetër një botë të re.

Kristaq Tutulani ishte një i ri, me kulturë të gjëre e me shije të hollë. Kjo bie në sy jo vetëm në shkrimet me karakter letrar, por edhe në artikujt, bisedat, fjalimet apo edhe letrat me karakter thjesht politik. S'është e vështirë të bindesh për këtë, kur lexon ligjratën që ai mbajti më 1 maj 1941 titulluar «Maji i luleve, i gjakut e i solidaritetit proletar», letrën drejtuar së motrës në shtator 1941, etj.

Artikulli i tij «Migjeni» është ndër më të thellët e më të rëndësishmit, që u shkrua para qërimit mbi poetin tonë të madh. Dy vjet pas vdekjes së Migjenit, më 1940, ai shkruante: «Gushti i parvjetëshëm na rrëmbeu

djaloshin, që ndofta do t'ish më i madhi poet i vendit tonë në këtë kohë» «birin e shekullit të ri» Migjenin, uragan i vërtetë, fryti i rreptë në shkretëtirën e «vullneteve të ndrydhura, të cilët i tundi me tërbim...»

Më poshtë, me shumë mprehtësi, ai nënvizoi atë çfarë kishte themelore në poezin e Migjenit: «Migjeni solli në truallin tonë një frysë të re poetike. Të re në çdo pikëpamje: Motive të reja, shprehje të reja, horizonte të reja, melodi të reja».

Pjekuria ideo-artistike e Kristaq Tutulanit duket edhe në veprat, që përktheu ai. Nga përkthimet që na kanë mbetur prej tij janë një fragment nga romani «Evgjeni Grande» e Balzakut, një fragment nga romani «Nëna» e Gorkit (fjalimi i Pavlit në gjyq). Po nga ky autor ai dha në shqip disa pjesë nga libri «N'Amerikë». Siç shihet, ai përktheu pjesë nga një kolos i realizmit, siç është Balzaku e nga themelues i realizmit socialist — Maksim Gorki. Kjo dëshmon se ai ishte nën ndikimin e letërsisë më përparimitare të kohës e kjo parashim ka lojtur rolin e vet në formimin e botkuptimit të tij, në përqafimin nga ana e tij të ideve komuniste.

Krijimi letrar që na ka mbetur nga Kristaq Tutulanë është relativist i vogël. Armiku fashist i rrëmbejn jetën në lulëzimin e rinisë dhe të talentit të tij. Veç kësaj, mjafth shkrime të tij kanë humbur. Por edhe nga këto që kemi në dorë e që u mblohdhën nën kujdesin e mëmës së Kristaqit, Kristinës dhe vëllait të tij Dhimitorit, mund të arrijmë në përfundimin se Kristaq Tutulanë ishte një letrar i ri me perspektivë. Ai ishte në atë fazë, kur jo vetëm po zgjeronte e po thellonte horizontin e tij, po bënte hapa të rendësishëm në paraqitjen realiste të jetës, por edheipo formozte individuatitetin e vet, stilin e vet si shkrimitar. Me vdekjen e tij të parakohëshme, ne humbëm një luftëtar të vendosur të lirisë, një militant komunist dhe një shkrimitar të ri, që do të kishte thënë fjalën e tij në letërsinë tonë të sotme të realizmit socialist.

Në vëllimin që po u jepet sot lexuesvet, natyrisht shkrimet e Kristaq Tutulanit nuk janë të gjitha të një

niveli. Ka edhe asish që botohen vetëm me qëllim që lexuesi të krijojë një ide për rrugën letrare të këtij autorit. Por këto nuk përbëjnë thelbin e vëllimit, janë plotësuese. Ky libër ka edhe një vlerë tjetër; plotëson vargun e veprave të shkrimitarëve dëshmorë të Luftës Nacionale-Çlirimtare, varg që u nis me vëllimin «Qiriu» të Gjikë Kuqalit, «Këngë për liri» të Memo Metos, etj.

Botimi i shkrimeve të Kristaqit ishte një detyrë kundrejt kujtimit të shokut tonë të paharruar; por, nga ana tjetër, ai ndihmon për ta bërë të njohur veprën letrare të një shkrimitari të ri, i cili, që në moshën më të njomë e derisa u masakrua barbarisht nga fashistët, nuk pushoi së punuari për të mirën e vendit e të popullit, të asaj Shqipërie, t'ardhmen e së cilës ai e këndon në mjast shkrime të tij.

Kristaqi s'arriti dot ta shohë këtë të lumtur Shqipëri. Por, në Shqipërinë socialiste, për ngritjen e së cilës, e ëlhe ai dha gjakun e tij, emri e vepra e Kristaq Tutulanit do të mbesin të paharruara.

Kahreman Ylli

Tiranë, 20.III.1965

... p. 1000. s. 1000. 1000. 1000. 1000. 1000. 1000.
1000. 1000. 1000. 1000. 1000. 1000. 1000.
1000. 1000. 1000. 1000. 1000. 1000. 1000.
1000. 1000. 1000. 1000. 1000. 1000. 1000.
1000. 1000. 1000. 1000. 1000. 1000. 1000.
1000. 1000. 1000. 1000. 1000. 1000. 1000.
1000. 1000. 1000. 1000. 1000. 1000. 1000.
1000. 1000. 1000. 1000. 1000. 1000. 1000.
1000. 1000. 1000. 1000. 1000. 1000. 1000.
1000. 1000. 1000. 1000. 1000. 1000. 1000.
1000. 1000. 1000. 1000. 1000. 1000. 1000.
1000. 1000. 1000. 1000. 1000. 1000. 1000.
1000. 1000. 1000. 1000. 1000. 1000. 1000.
1000. 1000. 1000. 1000. 1000. 1000. 1000.
1000. 1000. 1000. 1000. 1000. 1000. 1000.
1000. 1000. 1000. 1000. 1000. 1000. 1000.
1000. 1000. 1000. 1000. 1000. 1000. 1000.
1000. 1000. 1000. 1000. 1000. 1000. 1000.
1000. 1000. 1000. 1000. 1000. 1000. 1000.

1000. 1000. 1000.

I

V A R G J E

Shqipëri,
Hymn'i trëndafiltë,
Çelur n'agim lirije!
Në zemra djalërije
Rreth vattrash varfërije
Një këngë: «Shaipëri!»

Botuar në gazetën «DRITA»

Tetor 1961

LAMTUMIRË, DALLANDYSHE!

Sa herë dallandyshe më ke kënaq,
Sa herë më ke hequr nga të pafundshmet mendime;
Por kjo lumturi mbaroi me kaq,
Zërin e ëmbël s'do t'a dëgjoj as një th'rime;

Atë zë që dilte prej gojës tënde vogëloshe,
Atë zë që më jepte kënaqësi e gëzime!
Vall, o e mira dallandyshe, Zotin lavderojshe
Kur plot ëmbëlsirë nxirmje ato cicërimë?

Oh, pse kaq shpejt vjen, o i ftohtë?
Pse nuk vonohesh dhe pak kohë?
Pse nuk përtérihe dhe një herë, o i ngrohët
Dhe ai diell pse s'del të na ngrohë?

Ah! Ju rët e zeza shi pse lëshoni?
Nuk paski në zemër dhëmbshuri e mëshirë?
Në kët mënyrë ju po largoni
Të mjerën dallandyshe që ësht aq e mirë!

Oh, kini, kini për të mjerën mëshirë,
Se s'mundem t'i them unë asaj,
Nuk mundem t'i them lamtumirë,
Se kur t'ikinj ajo s'kam prehje pastaj.

Por mua të mjerin nuk po më dëgjojnë,
Vjeshtën nuk mundet që t'a durojnë,
Tufë, tufë u nisën dhe, ah, po shkojnë
Dhe mua të mjerin shum' më hidhërojnë!

«Lamtumirë o èngjëj» t'iu them fillova,
«Lamtumirë o të uruara nga Zoti fuqiplot,
Kështu tash dhe prej dritares u largova
Duke fshirë me shaminë lott.

Botuar në «VATRA E RINISE»

15 Tetor 1933

U THANE GJETHET!...

Kurse pranvera zgjonte lulzimin,
Kurse gjithësija merrte tjatër fytyrë,
Kurse zogjt e vegjël ëmbëlsisht cicerinin
Dhe tingujt këndshëm hapnin në natyrë.

Ahere dhe pylli shum' u zbulurua,
Në vënd të së vjetrës ngjyr të re pranoi,
Me gjethë të blerta bukurisht u mbulua,
Nga gazi bilbili nat' e dit këndoi.

•
•
Porse ato gjethë tashti, ah, u thanë!
Se s'durojnë dot të ftohtin që erdhi,
Dhe loti i tyre krejt tokën e verdhi.

Nga zemra e pyllit dëgjohej një mekje
«Ah, gjethet» — thoshte «na lanë të shkretë!»
«Nuk pati mëshirë kjo e zeza vdekje»
«Por s'kemi ç'të bëjm, kështu e ka kjo jetë».

Botuar në «VATRA E RINISE»,
19 nëndor 1933

VALLE ZANASH

Nga sheshet e Tomorit, ng'ato sheshe hyjnore,
Ng'ato sheshe tē shkelura prej Zotit Pellaspjik,
Ndën hijen e lajthive, buzë projve argjendore,
Një këng' e bukur dëgjohej me një rithëm magjik.

Në qellin e pastërt tē plakut Tomor,
Nga jone t'madhnueshme ajri valëzohej
Që ëmbëlsisht p'rhapseshin si hym'n engjëllor,
Oh, sa qe e bukur kënga që dëgjohej!

Të gjitha duke kënduar vallzonin dor' për dor'
Drithnin delikatshëm trup'n e tyre meskëputur.
Oh, atë trup tē bardhë si dëborë
Të mbuluar me një fustan në holl' e tē bukur!

Syt e tyre tē zes ndën vet'lla harkore
Pasqyronin g'zimin q'zemrën u përshkonte
Prej goj'vet t'kuqe me zëra engjëllore;
Oh, me sa hijeshi kjo kangë kumbonte!

«Gëzonju Shqipëri, se djem petritë ke,
«Djem sokola mali, trima tē pavdirë,
«Që derdhin gjak'n e 'tyre për liri e Atdhe,
«Që vdesin gjer më një, që tē rrojnë tē lirë!

*Botuar në «VATRA E RINISE»,
9 mars 1936*

PËR TREVJETORIN E «VATRËS SE RINIS»

O yll drit' — prurës, që për tre vjet ndriçove
Me dritën tënde t'ëmbël rrug'n e djalëris,
O yll që për tre vjet' zemrat tonë g'zove
Me shkrimet e tu' t'ëmbla, o Vatër e Rinis!

Ty o drit' qiellore, ty të falet sot
Një brez i tëri'i të ardhmes shpresë!
Duke të uruar vullnet të mir' e plot
Lumni në rrugën tënde, o Vatër, thérret:

Agoft' djell' i bukur n'këtë dit' gëzimi,
Agoft' e ndriçoftë kudo gjith djalërin,
Në çdo vepër e udhëheqti përparimi
Për të lulëzuar atdhenë, Shqipérinë.

O «Vatër e Rinis»! Jehonë gëzimi
Që sot kumbon në sa goja fëminore,
S'gjej dot fjal' të mira, fjalë lavdërimi,
Për ty që për ne je drithë qiellore.

*Botuar në «VATRA E RINISE»,
9 shkurt 1936*

SI IKIN VJETËT . . .

Si ikin vjetët, motër . . .

Një pas një

Rrëkellehen

Me mospërfillje në fund te një humnere . . .

E një pluhur harrese mbulon çdo gjë . . .

E një kujtim i errët mbetet nga çdo gjë,

Si një dehje vere,

Ndërsa vitet, një pas një,

Në të kaluarën rrëkellehen

E zhduken, oh, si zhduken, motër ! . . .

Ne ishim të vegjël,

Ne ishim fëmij,

E zemrat rrihnin fort, sa fort,

Kur nëna pran na ftonte

e na përgëzonte,

Kur baba na puthte në ball

Me mall!

Kur gjyshi mbi gju na ulte,

A u përkulte

Për të buzqeshur e pér të na ledhatuar,

E ne s'njihnim veç lojna, veç dëfrime,

Veç shëndet e këngë-e valle e harbime.

E shtëpija jonë ish çerdhe e gjëzuar . . .

E ne duheshim sa fort oh, sa fort,

Kur ishim të vegjël,

Kur ishim fëmijë! . . .

Si iku ajo kohë, motër,
E si na u shkatërrua
Pelhur' e ëndërave tona të fëmijnis' së parë?...
O Zot, se ç'kujtime të ëmbëla në një kaos të zi
banojnë!
E vaj!
Me gjithë se të largëta e të harruara
pothuaj
ditët e voglis' më shfaqen, më mundojnë,
O motër,
që kur hap sytë gjithashtu më rrëthon,
me kuvëndon.
Oh, si t'u shkatërrua
Pëlhir' e ëndërave të tua
E fëmijnis' së parë?...
Ku është ajo kohë, motër?!...
Oh, si ikin vjetët, motër,
Të njëllojta, monotone, ngjyrë hiri!...
I ditëve e i javëve si vazhdon i pa shkëputshëm
zinxhiri!
Si ikin vjetët, motër!...

KUJTIM I FOSHNJËRISË, KËNDONA

I

As eja, motër të shtyjmë me ngadalë lundrën e kujtimit,

Të çajmë lehtaz ndër shkulma shkumbëuar

Të detit të gjërë të Endërimit!...

E prej kësaj qen' jeje të ikim shqim,

Për t'u tretur në përmallim;

As eja, motër!

As qasmu, qasmu këtu në vetmi,

Të çelim së bashku portën e artë

Të së kaluarës fat-lume!

Le të derdhen në shpirtet tona malle të vjetra!

Le të kumbojnë në shpirtet tona edhe një herë

Orët e arta të fëminis së trëndafiltë,

Që rrëshqitën, lehtë — lehtë,

Si lundra e peshkatarit në të kthjelltin ligjer!

A ndjen se ç'rënqethje përftojnë
shpirtet tona.

Kur stin'e fëmijnis hap gjinjt e saj

Si konxhja në Pranverë?

Sa figura t'endura me aqë mituri

Të ëmbla, sa të ëmbla, për t'u ruajtur në kraharuar,

Si një visar i çmuar,

Na hapen, motër, në heshti!

Mbi kodra tē vjetra
Këngës as ja thuaj,
O kujtim!
Tē dehemë duke t'adhuruar
Në një shtërngrim
Tē zemrës sonë tē mjerë,
Oh këndona, këndona!

II

Ne ishim tē mitur,
Ishim pa tē keq...
Dhe dita sa e ëmbël ish në refrymim...
Çdo e dredhur ajri se ç'trandje tē dlirta sillte...
Me ç'të papritura përmbushej rrrokull'i muajve
t'shpejtë!

E në ç'të reja ndënëqeshte gjithësija!...
Jeta ishtë e ylyvertë ndën një tē bukur agim,
Kur mëndja jonë kërkonte,
Herë duke u gëzuar,
Herë duke lotuar,
Por loti s'ish i hidhur atëherë,
Atë që s'gjendet asnë herë...
Legjionë tē misterëshme truri i ynë përcillte,
Truri i ynë, që u mundonte
Në mijëra marrëzira,
Të një bote q'ish e bukur e ku shndriste lumturija.
Po përse, vallë, kjo botë e mjerë
Na dukej aqë e re
Dhe me tē dashura fytyra
E t'gjalla ngjyra
Farfuritte,
Xixa qitte?
E përse pastaj këto u zbehën e u zbërdhënë
E humbën atë lezet që dikur pâtën?
E ylli i ynë që i shkëlqyeshëm në zbardhëllim;

Pa ardhur mesdita e jetëve tonë,
Në vënd që të ndriçojë
E të na gjëzojë,
Përse ndërmjet lotimeve memzi duket kah ndrit aq
zbetë?
A thua se është e vërtet që për të gjetur pakëz
lumtëri,
U dashka mituri,
E që kësajëndre të bukur vjetët i falkan flatra,
Për të rendur me të katra,
Pas një ndënqeshje të ëmbël plot hare?

III

Kur ishim të mitur,
Kur ishim pa të keq...

Kujtim i foshnjërisë këndona, oh, këndona!

AS EJA FRYMËZIM

As m'a ledhaton lyrën me flatra ängjëllore
Si zefiri lulen, kur Prilli ndënëqesh,
O frymëzim,
Por ah, o i pashpirt! Qysh i tärbuar frashi
Ç'po m'i këput kordat që utërijnë,
Si me dhëmbje e llaftari!
Në një heshtje shpirtërore,
Her' me mall, her' me durim,
Të prita frymëzim.
Por ti, o zémërgur, përse
Më vjen më shpirt i zemëruar
E fyma jote shungullon
Si nj'akuillon
Si nj'akuillon
Që harpin ndesh?
As qasmu, frymë qiellore
Dhe heshtur hyr në shpirtin tim!...
E zgjo, i shejti frymëzim,
Në lyrën time të mjeruar
Akorde hyjnore!
E jo si sot që më dhe të pi
Në kupën tënde vrer e helm të zi.

Oh, dua hare...
Le të dehem e në gjak le të më lëvrinjë,
Buçitje, entuziazmë e zjarrmorë,
Të ndizem horë
E mbasandaj — oh, mbasandaj!

Të këndoja e të këndoja, pa pushim.

Por vaj!...

O frysémizim, ike më le...

*Botuar në «ZËRI I RINISE»,
9 janar 1963*

ETJE PËR VETMI

E i thirra unë pyllit atëherë;
Prano, o Perëndi i vetmis,
Në tempullin e shenjt të lendës sate
Do të varfëra fli
Nga një i varfër këngëtar;
Një zemër të pastër, ndonse të cfilitur,
Një shpirt krejt të thjesht, ndonse i zhuritur,
Një lyrë të heshtur, ndonse në ar ndritur
E bashk me to prite në heshtë
Hymnin që të blatova
Dikur, ndaj një mesnate,
I mërzitur prej njerzisë,
Se s'gjeta, oh! ç'kërkova!

E i vikata unë pyllit edhe një herë:
— As hapi gjinjt e tu gjinjt e qetësisë
E pushtomë
E shtërgomë
Me zjarr;
Jam n'dor tate.

II

E i thirra Zanës sime atëhere;
Mikesh' e zemrës sime,
Të dua, kah këndon
N'ujin që gurgullon,
Në gjethe e gjelbërimë
E në shkrepë të thepisur!

Kur jam në vegim tret
Sa të dua
Të të kem ngjet,
Të të sodis...
Por, o muzë e vogël, sot dashkërkam qetsi të
plotë.
Të zhdukem nga kjo botë,
E çdo gjë që më lidh me të, tej, larg ta vervis
Sa dua...
(E thuaj po deshe se jam i krisur!).
Prandaj, o pëllumbeshë, të humbas ndihmnomë!
E n'qetsi varri lëshomë!
Jam i mërzitur prej njerzisë,
Se s'gjeta oh, ç'kërkova
E i vikata së bardhës edhe një herë:
— As më siguro qetësinë, o Zanë e bukurisë,
E fshehtas pa m'u çfaq, nga kjo jallane largomë!
Prej t'gjithve, edhe prej vetes sate
Puromë,
Jam n'dorë tate.

III

Mungon
Flutura ime
K'ah plot gaz e hare plot,
Shend e verë
Endatare,
Lajkatare,
Si nga herë
Flutura ime,

Përkëdhelur në ajri, gjith harbon
E nget e nget e fluturon.
As më jesh ndaj një vegimi, ku përkunden
vegëllime,
Këtë zemër, që pikon
E gjak e lot,
O Zot!

*Botuar në «ZËRI I RINISE»
9 janar 1963*

SOT, VILLA, Ç'ËSHTË JETA?

Sot, vlla, ç'është jetë?
Endër asgjësije,
Pa jetë, pa shije...
Ku ësht' e vërteta?

Të shof, o njeri,
Tek po hiqesh zvarë...
Në jetën e marrë...
Ku je lumtëri?

O ti që loton,
Që në kishë ngutesh,
Para korës lutesh,
Më thuaj, pra, ç'fiton?

Ja ku tiranija
E lirë të batis
Dhe të qesëndis!
Shpreson te lirija?

O vlla, ç'është botë,
Fole dashurije ? !...
Provë perëndije ? !...
Pallavra të kota!

O ti që jetove,
ti, ç'të mira pe?
Gëzove hare?
Që rrrojte ç'fitove?

Pra kjo botë sot
Është pa kuptim,
Është për sundim
Oh! për vuajtje e lot.

Njeri, mos beso
Se ka paqë sot
E shpërblime mot,
Bot' të re kërkoi,

*Botuar në «ZËRI I RINISE»
9 janar 1963*

PORSE NJË KASOLLE . . .

Oh, se sa të buk'ra tani lulet janë
Ndënë te kuqërremet zjarre, oh, t'agimit!!...
Furfurit'shëm vese, ato hapin gjinë.

Porsi vala deti shtres' e gjelbërimit
Rrukulliset ëmbël, përshëndet puhinë
Ndën' të trëndafilitat zjarre, oh, t'agimit!

Pranvera e lulet sot ëmbëlsi kanë. . .

II

Porse një kasolle, rrethuar' bukurije,
Përse s'kridhet vallë, n'haren e gjith'sisë?...
Vë buzën në gaz i purpurti agimi. . .

O jetë, përse? Pse vaj' i një'r'zisë
Fshihet bukurije — e sysh na humbet shqim,
Agimi që po ndjell agim'n e lirisë? . . .

Konstrast?!... Ja, pik'la vaji dhe bukurije!...

SHOKUT TIM S. A.

Një këngë të zjen në gji,
Vlla,
Dhe ti pyet ç'është vallë kënga që nuk këndohet
dot?
Ç'është kjo magji?
Dhe kot.
Kot; me lahitë kërkon të këndosh atë që nuk kën-
dohet dot.
Ti mund të nxjerrësh fjalë,
Vetëm fjalë.
A e nxjerr dot zemrën tende. se ajo është këngë, vlla?
Kënga jote, kënga ime, gjithë ç'janë shkruar e kënduar
Janë vetëm një psherëtim e thatë e këngës së vërtetë
Q'është zemër në krahëruar,
Q'është jetë,
Q'është gjithëshka.
C'është këngë e vërtetë, po më pyet, vlla?
Oh ç'është këngë e vërtetë!
Shiko, ngreje kokën, vështro yjtë, që po derdhin lotë
argjendi,
Dëgjo zérat e dremitur të mjerimit posht në fshat,
Ndjej parfumin e lirisë që po buron te këndi,
Mall'i djegur pështet ballin përmbi krah a përmbi shat.
Gjithë kjo èmbëlsirë e vuajtjes, ky llahtar i bukurisë,
Gjithë ky hidhërim i ndarjes, gjithë malli i madh i
pjekjes
Një ide që vetëm i tund themelet e njerëzisë
Dhe një agimi, e një tjetër në gji të vdekjes
Mall i math i jetës parë, èndërim i Botës Re.
Dashuria që përvlon në gji të vashës së re

Frik' e lypsit, kur për jetën sheh fytyrën e gogolit,
Lot' i nxehtë i syrit tënd, dridhërim' e shpirtit tim,
Tërë zër' i gjithësisë, tërë ngjyra e hapësirës,
Çdo parfum e çdo flamur, dhe çdo luftë e përqafim,
Gjithë t'errëtit e dritës, gjithë drit' e errësirës.
Ja, kjo sinifoni e gjallë, ku lëkundet lundëra jonë,
Zër' i jetës, zër' i vdekjes, zër' i zjarrit, zër' i shpresës,
Që në zemër të secilit gjen e ndez të fortë jehonë
Dhe që ndrit, margaritar, si mbi lule pik' e verës.
Është kënga, është fjala, poezia është;
Shkrihu, pra, vlla i dashur, shkrihu bëhu kënga jonë.

NJË KËNGË

Një këngë më zjen në gji,
Një këngë, këng' e lirë, këng' e lumtërisë.
O Zot, se si më zjen kjo këng' e lumtërisë
Në gji ! . . .

E mbrujti një vuajtje, e gatoi një lot.
Ësht' e ashpër, pra, kënga që më zjen në gji,
Ësht' e egër si i shqypes fluturimi,
Ësht' e egër si i tufanit tërbimi.

E ca më tepër e egër si marrja e gjakut në malësi
Kënga!
Padrejtësija, Gënjeshtra që mbretërojnë rrëth meje
M'a aratisën. . . E si të mos jetë e egër, atëhere, kënga!
E ajo vlon — oh, se si vlon! —
Ajo këndon — oh, si këndon! —

Këndon lirinë
E dashurinë
E vëllazërinë
E lumtërinë
Që agon në të purpurtin agim
Të djellit, që ndriçon shpirtin tim
E që përflak
E që përgjak
E shkëmb' e vopël¹⁾ e lisa tatëpjetë
(O bukuri që ndriçon kot
Skëtëren e quajtur jetë,
Sa i përngjan këngës që vallzon rrëth meje).

1) vopël = gur.

O këngë, këngë lirije,
Këngë, që s'dëgjohesh kurrë,
Buçit, jeho si të ka hije,
O këngë, që zhurit,
O këngë, që rronit,
Të ziun shpirtin tim;
O këngë që s'dëgjohesh kurrë
Buçit, jeho e ndizna horë,
Se zémëra jonë e gjorë,
Kredhur në pellg të mjerimit zi,
Ka nevojë
Të dégjojë
Tinguj hafkëllimash, tinguj oshëtimash
Të një bote të shuar...
Jehona plot zjarrmi — oh tinguj të ri —
Të një bote që merr jetë
Në paqë, e bekuar...
O këngë përsë hesht, rri e nemitur,
O këngë, këng' e lirë këng' e lumtërisë,
E egër dhe e butë që po më zjen në gji?

*Botuar në «JAVA»,
9 maj 1938*

RRUGA ËSHTË E BARDHË

Poshtë rruga është e bardhë...
Udhëtarët vogëlushë në rrobe të bardha dëborë.
Porsi flatra ëngjëllore,
Ndërsa tej, ndaj perëndimit,
Si kuror' e kaltërimit,
Të një dite pranverore,
Atje tej në fund të qellit të kulluar, të kristaltë,
Atje tej në majë të shkëmbit kërcënues e tmerrues,
Purpur gjaku, purpur zjarri është rrethuar qark nga re.
(Sa të bardha, oh, sa të bardha si kope!)
Dhe kur atje lart vallzojnë — oh, se sa hije të kuqe!
Këtu poshtë në rrugë të bardhë po nxitojnë tri bur-
buqe..

E m'e lehta,
Më e hiedhta,
Më e shpejta nga të trija,
Sa e bukur, sa e qeshur është hyrija...
Edhe dielli madhështor po rrëshqet me furi,
E një dritë kuqerreme shkulma-shkulma rruku-
lliset

Tatëpjetë.
Me t'u lye shkëmb i vogël në të kuqe
E shtullunga resh të bardha, me t'u lyen në të kuqe
Si katundi rrëzë mali, prroje, pyje e kasolle
E një natë prej safiri n'amën tjetër arratiset.
E pas pakë udhëtarët po na hyjnë në katund
E një gaz, një mall i ri zemrat seç ua lëkund
Edhe shkëmbi larë në gjak çaste heshtie sodit

Posht rrugën q'është e bardhë
Drita shuhet, nata ndehet,
Hëna del për të notuar në ajri,
Por kur utërima shqimet edhe brenga hesht, pushon...
Dhe kur gjithësija prehet,
Zemrën time seç përshkon
Një breng' e re, një zjarr i ri
E një epsh se ç'ndizet flagë, se ç'ndjek, ç'e
përvëlon !...

**Botuar në gazetën «ZËRI I RINISE»
9 janar 1963**

E P S H

E ndjeva n'atë mbremje vere,
Mbi shkembin lar'në gjak, që heshtur soditte
Yllin e Dritës, duke u kredhur në valë të
shkumbëuar.

N'atë çast të trëndafilëuar,
Prej shigjetash perëndimit, si çdo gjë të trëndafilëuar,
E njojta, kur flatrat e zefyrit valë ajri lindnin,
E kur ndër gjethe të portokajve
Lindnin
Hove-hove pëshpëritje... Oh, një botë e ëmbël
mjaltë! —

E ndjeva
Të merrte jetë në fund të shpirtit tim.

E ndjeva
Të më lindte në fund të shpirtit tim,
Të më dridhej — Oh, se si dridhej! — në fund të
shpirtit tim,

N'atë mbrëmje vere,
I dehur nga parfum' i protokajve,
Në një gji deti farfuritë
I kristaltë.

E rrita me perkule
Buzë lijeni,
Mbi zall margaritari,
Përmes kopshtijesh erëmirë;
E lëndinash
Trëndelinash,

Në lëkundje të mëndafshta kalliri,
Në ballkone mermari,
Në netë safiri
Ndën kandij ari
E zbavita e e zbavita...
E gjithkund
Në një ëndërim pa fund,
E shëtita e shëtita...
E josha prej tinguish lyre...
Me harpë e dëfreva...
Mbi vegime e ndjeva...
E mbulova me lule...

E ndjeva n'atë mbrëmje vere.

II

E prapë në një mbrëmje vere,
Kur lëmshi i zjarrtë jepte shpirt prapa lisash të
gjatë,
E kur ti pranë më kalove
(as me sy s'më shikove,
As me gojë s'më këvëndove
E bukura jeme!)
Zana m'u ul pranë e në vesh më pëshpëriti
↳Epshin, që dikur trajtovë,
Që me kujdes t'a rriti
Shpirti i ngratë
Dhe porsi një flutur e harbuar,
Krahë praruar,
Të kihet e të ndjek kot
Dit' e natë
S'e zë dot;
Në vështrime endjesh e ka folenë;
Në puthje të zjarra e ka djepin që përkund harenë,
Dehje, ndezje, drishtirë, afshe, shije qumështore,
Që të ndezin horë,
E joshin, o këngëtor i ri,
Si për magji.

E, pra, vajza që po kalon
E që po të vjedh zemrën e po të huton,
Pronë e ka dhe e sundon —
Si ti, lyrën tënde që t'është venitur
E shuar,
O èndërtar i raskapitur»

III

Sa e bukur ajo mbrëmje vere...

Pas çdo puthjeje që na kridhte në përcëllime
Buzë rubini ndënëqeshnin me èmbëlsi
Faqe trendafili, shkëlqenin (ç'bukuri!)
Tufa t'arta floku, andej — këndej valviteshin
Vështrime volupteti ndërmjet një duvaku qepallash,
Në përfundi vërviteshin
Të etuar —

A çeleshin syt e zes, çeleshin e ndriteshin
Për të rrëfyer gëzim, që dukej i amëshuar...
— Oh magji prallash! — ...
E pastaj prapë puthje, përvëlime...

E gjithëjeta ime e qartë deri atëhere
Më veshej, më dridhej,
Më davaritej shqim,
Në pafundi më kridhej...

Sa kujtime nga ajo mbrëmje vere!

SHTEGËTAR...

Eca dhe eca,

Shtegëtar

I dashurisë, kërkimtar,

I etur, për lumtëri,

Për puthje, epshe e për një vegim

Që oshëtima zulmesh e shpresash zgjon.

Eca dhe eca

Deri sa këmbët m'u raskapitën fare,

U ndala,

U preva,

Mbi tokën e ftohtë, kur nata magjistare,

Që në gjin e saj me mall të rinjtë fton,

Mbi lisat e pyjeve errësirën endi

Dhe në te kuquremin agim

Prap eca dhe eca

E me nxitim

E male e fusha e zabela si një shigjetë.

hedhur furishëm prej më të mirit shigjetar

Depërtova e kapërceva,

Shtegëtar

I palodhur kërkimtar

I lumturisë së vërtetë,

I dëshëruar për një çast gazmendi

Për puthje, zjarrmi,

Gjithënjë eca dhe eca...

Një ditë kur isha rrapatur fare
 Kur shigjetari i purpurtë rrëmbente
 Me hov

Maja pemësh e pullazesh e kumbonaresh
 Vështrimi im i humbur hasi syt'e tu,
 Të zes, të bukur, plot hijeshi.

Syt' e tu, peri,
 Syt' e tu.
 Me hov

Një ditë kur isha i drobitur fare,
 Kur Mbreti i ditës në Perëndim shkëlqente
 Dhe mike n'ata sy
 gjeta,

Kur vetëm me ty

Mbeta

Ndënë një kupëz t'argjëndët pikash ari qëndisur
 Të ëndërave të mijë, idealin e shartisur.

A BLEHET ME FLORI?

Se ç'mbresë,

Oh, ndarja e papritur më mbolli mu në gjë,
Në zemrën e rronitur të bërë shkrumb' e hi,
Veç shpirti im ma di!

Se ç'dnesë,

Se ç'vrerë e ç'lot i hidhur, kur isha larg nga ti,
M'u ndalti mu në grykë!... Do t'ja tregoj në heshti
Veç varrit tim të zi.

Se ç'shpresë

Të re e sa të ngrohtë më fale, se ç'qetsi,
Kur një vështrim të ëmbël me hodhe përsëri!...
A blehet me flori?

DO TA MBYLL NË GJI

Oh, nuk mund të vi,
I dashur bari,
Fyellin të dëgjoj
Buz' atij përroj!

Po më telendisin
Bota nëpër fushat;
Shënderive fisin
E nxive tët at!

Se si më vështrojnë
Kur shkoj un' në krua,
Gjith' që kuvëndojnë
Vetëm po për mua.

Më qafsh, nuk vij dot,
Nuk vij dot në pyll,
Mallin tim që sot
Në gji do ta mbyll.

Do ta mbyll për jetë
Në gjin e rronitur,
Mallin tim të shkretë
Mallin e zhuritur.

E KA DJALI

I

— Eja moj këtu me mua,
Je e ëmbël — o
Je e bukur — o!

— T'u thaft' goja, bari, ç'thua,
Jam e mitur — o
Shum' e mitur — o!

(Çupa s'është pér t'u — kapur,
Duro djal-o, s'mund të vijë,
Trëndafili pér t'u — hapur
Po pret kohën të arrijë)

— Eja moj pér bukurinë
Se të dua moj,
Shum' të dua moj.

— Po ç'më thua bari, tinë,
Oh, kam frik' o ti!
Kam shum' frik' o ti!

(Vashën, o bari i mirë,
Lere se ngjan me burbuqet,
Rrushi ësh't i pa harirë
Vjeshta qaset, pastaj skuqet)

Erdhi vapa, erdhi vera,
Nd'arë na u verth kalliri,
Pastaj vjeshtës pihet vera,
Vashës zu t'i fryhet gjiri,
Fyelli nisi, delet nisën,
E ka djali pér nga herë.

THUAJMA, THUAJMA MUA.

I

Kur shkove ně krua,
Ti moj bukuroshe,
Kur shkove ně krua,
A mos e pe trimin?
Thuajma, thuajma mua,
O moj pitikoshe,
Trimin mos e pe
Gjith'gaz, gjith'hare?

II

Po kur t'u afrua
Ty, moj pällumbeshë,
Kur t'u afrua,
Thuajmë a u skuqe?
Thuajma, thuajma mua,
E vockël bareshë,
Mos u drodhe pakë?
Mos u skuqe flakë?
Kur të tha: «të dua»?
Lule trëndafile,
Kur të tha: «të dua»,
Mezin a ja fale?
Thuajma, thuajma mua,
Lule trëndafile,
Puthja nuk të ndezi,
Gjat këtij mëngjezi?

Botuar në «ZËRI I RINISË»,
9 janar 1963.

MALL PËR ATDHE

Si rrebesch derdhet e riderdhet në shpirtin e zhuritur të shqiptarit malli i kthimit n'atdhe. Ngjallet nga kujtimi i gjërave të dashura e i jetës së bukur, i të kaluarës së këndëshme, rritet prej përfytyrimit të bukur. Mall i madh për fshathin e bukur, ku pamë për herë të parë dritën e djellit e zbritëm në jetën e keqe të pamëshirëshme; për kodrat, për luadhet, që e rrëthojnë, ku qëndronte lumturia e foshnjërisë sonë, për lumejt e përrenjtë shushrima e të cilëve, muzika më e émbël që dëgjuam në jetën tonë, na lidhi me zinxhira të padukur, që nuk na lënë të harrojmë vëndlindjen tonë e na tërheq të kthehemti aty malli për vatrat, rrëth të cilave kureshtja jonë miturake kënaqej në dëgjimin e përrallave, që me émbëlsinë e zakonëshme na tregon gjyshja, duke i shoqëruar, natyrisht, me një «kurban nëna» pareshtur! Ah! Ky mall për çdo gjë që ndodhet atje, copëton dëngadalë shpirtin tonë.

Rinia është dashuri, lule dhe dashuria pema e saj.

ATDHEU

Zemrat e atij shqiptari, që ka lindë në malet e fushat e bukura gjelbërlore të këtij atdheu, ka qënë, është do të jetë një zemër e thjeshtë shqiptare, një zemër që do kurdoherë vëndin e saj lindor të dashun, kasollen e paharrueme, atje tej, larg, ndoshta mbrapa malesh; majë shkrepash e përmes pyjesh, atje ku ndoshata s'ka as një shënjë gjallësije, po prapë e do atë e atje don të vdesë, atje don t'i shplodhen eshtrat, atje don që të ketë shtëpinë e tij të pérjetëshme.

Gjithëshka mund të harohet. Mund të harohen dashunitë, kujtimet e të këqijat e kohës së kalueme, dhimbjet, gëzimet; harohet çdo gjë, por jo dashuria ndaj Atdheut të dashun e të shenjtë.

KUJTIM DHJETORI

Yll'i mëngjezit më s'dukesh, se ret' e zeza mbulonin qielin, er' e tërbuar çante qytetin e rrethet për të plotësuar kapriçjot e saj. Ah, kapriçjot e padrejta të natyrës që s'pushojnë së ngacmuari të varfërit e mjerë, kapriçjot e egra që s'i lënë të mjerët në hallet e tyre, në hallet e urisë për bukë, po iu shtojnë halle mbi halle; janë në të vërtetë të mallkuara. Po pse, o natyrë kaq' e bukur, e ëmbël, e dashur e e dhimbur sipërfaqësisht të jesh e egër, katile e pa din e iman mbrënda? Është misteri më i quditshëm i jetës, është prirja që ka kjo jetë të jetë gjithënjë e padrejtë, e ëmbël e e bukur për disa, e egër e e pamëshirëshme për të tjerët; është mallkimi më i rreptë që ka bota.

I gjithë qyteti ishte në heshtje. Asnjë zë s'pipëtinte. Do të duhej edhe ndonjë gjysëm ore që të varfërit shegertë, duke u dridhur ndënë rrrobat e grisura, të çelnin qepenat.

Pemët e zhvilluara e bedunicat¹⁾ lakuriqe, duke iu përkulur natyrës pëshpëritnim një lutje të vogël mëshirëkërkuese. Përveç kësaj pëshpëritjeje, që mbytej prej vërvhellimës së tërbuar të erës, asgjë tjetër nuk ndihet.

Ah jo: ndihet edhe dishka tjetër, por era s'të le t'a ndëgjosh; ndihet zë njeriu. Atje larg, ku lehtësisht zbardhon rruga e Kalasë, ja tek shifen 4 hije, shifen fare pakë, forma s'u dallohet mirë, se mjergulla e dendur nuk lejon. Le të qasen më afër! Ja! Janë 7 trupa të kë-

1) Bedunicat — sherbela.

rusur e tē shtatē shamit e zeza vërtetojnë që janë gra. Ja se si i kanë mbështjellë kokat e tyre me shamit e grisura që ju mbulojnë edhe veshët, duke lenë tē duken vetém fytyrat e thara prej vuajtjevet dhe martirizimevet që u ka vënë si barrë e thëna e hedhur pér ta. Po ku jeni, o tē pasur, eni, afrohuni, shifni sytë e tyre tē futur në eshtra, shifni kockat e dërmuara nga vuajtjet që ju s'mund t'i përfytyroni dot, mbasi s'i kini njo-hur se si mbështillen prej lëkurens së verdhë. Ah! po ju tani shifni ëndra tē këndëshme në gjumin tuaj tē rëndë, natyrisht tē rëndë nga lodhja që patët mbrëmjen e kaluar, duke dansuar dhe nga vera pesë vjeçare, ose nga shampanja e shtrenjtë që pitë!

Ja se si era u bën dallgë në rrobet e tyre tē reckosura, se trupi i tyre është i hollë, i hollë fare. Por tē ngopurit nuk shohin tē tilla skena tragjike, sepse nuk u vjen mbarë t'i shohin, s'e vlen mundimin e tē shkuarit në ndonjë lagje tē varférish, sepse atë kohë që do tē shpenxojë ai duke shikuar fëmijët që qajnë pér bukë, djemt që s'kanë rrobe e vajzat që treten si qiri, e shpenzon fare bukur në ndonjë kabare, dancink ose në ndonjë kolltuk tē rehatshëm. Ah, botë pa din e iman!

Ja se si këmbët e plasura prej morthi përpiken mbi gurët e ftohtë pér tē kërkuar pak nxehje. Por, o mallkim i botës, si do tē kenë mëshirë gurët e ftohtë pa zemër, kurse ndodhen njerëz — bisha që s'preken prej vuajtjevet tē tē tjerëvet si pér tē vërtetuar fjalën tragjike: «Thika s'dhëmb në mish tē huaj...».

Kolla e pamëshirëshme i mundon gjithënë tē mjerat që shkojnë kryeulur pa bërë zë, duke menduar hallët e tyre. Ndonjera nuk do tē ketë as ndonjë muaj që i shoqi i vdiq, e ndonëse e dërmuar nga mjerimi i pangushulluarshëm, i duhet tē lerë shtëpin' e saj, tē lerë vetém fëmijët e saj tē njomë, se është mjerimi i përditshëm, armiku i pështirë, mungesa e bukës, urija e mallkuar që e detyron. Dhe e mjera çel buzët e saja, duke lënë tē duken dhëmbët e saja që përpiken pa pu-shim njeri me tjetrin. Bashkon duart e saj tē trashura, ngren sytë nga qielli e mërmërit: «Ç'të keqe tē paskam

bërë, o zot, që tërë të këqijat i mblodhe mbi mua? Dhe zoti s'përgjigjet, s'përgjigjet për padrejtësitë e kësaj bote; e pafajshmja vuan, kurse sa e sa fajtorë rrojnë të lumtur!...

Kolla i mbyt dhe ato ecin të heshtura. Era vërtit zërin prekës të kollës dhe, posa e sjell në veshët e tu, ti preke prej asaj e ndjen n'atë zë monoton lutjen më prekëse që mund të drejtohet; të duket sikur n'atë zë ndjen dishka që të rrëfen dhëmbje dhe vuajtje plagësh të forta. Atë zë, pra, duke e vërtitur në krahët e saj e duke e shtytur përpëra e shpie në ndonjë shtëpi të pasuri, por dritaret janë të mbyllura dhe ai fle i qetë mbi shtresën e butë i mbuluar me mbulesa të ngrohta pa menduar aspak mbi trageditë e jetës...

Kolla i mbyt dhe ato ecin të heshtura! Ku venë?... Për të mbledhur ullinjt e të pasurvet! Për të vuajtur 12 orë të gjata midis sa e sa të këqijave për dy lekë të shkretë! Ah jetë, jetë, pa din e iman!...

10-XII-1934

*Botuar në gazeten «ZËRI I RINISË»,
9 janar 1963*

TUE SHIKUE RRUGËN

Isha në shtrat e flinja duke ëndëruar me shpresë... Jasht ishte agim; hëna verdhacake kishte dhënë dritën e saj të zbetë e pastaj ngadalëshëm ishte futur prapa malit, për t'i treguar njerëzve se jeta në këtë botë është si një film sinematografik, i cili ikën me shpejtësinë e një varke, që çan ujrat e qeta të një ligjeni. Largohet, largojet e më së fundi na len lamtumirën e ne e harrojmë si kur një dorë e pa dukëshme t'a hiqte nga trutë tonë...

Nata kaloi dhe nga jeta e njerëzve u hoqën disa orë. Dielli shkëlqen madhështor mbi Tomorrin vigan dhe qielli u ndriçua prej tij.

I qetë flija e nuk shihja asgjë... kur një dritë e holë përshkoi ledhatueshëm shtratin: një dritë magjistrale që i bëri syt e mi, të vulosur me vulën e gjumit, të hapeshin. Ishin të parat rreze diellore që anë e kand botës rrëfënin ndryshimet e shpeshta të jetës sonë të parregullt.

«Gjumi i mëngjesit është i ëmbël» — ka thënë dikush — dhe mua ashtu më ngjajti — ... Në vënd që të ngrihesha e të fillonja me mësue mësimet, u ktheva porsi përtac në anën tjeter e fjeta përsëri. Por se përsëri ky gjumë i dytë u pre prej një cicërimë të ëmbël; ishte zëri i një kreaturë që, ndënjur në dritaren time, këndonte me mall, sikur donte që zëri i ëmbël i saj t'arrinte deri në quell për të lavdëruar Dorën krijonjëse.

Të faleminderit, o Dallëndyshe e vockël, që më shkunde pluhurin e përtacisë!

Si prej magneti u tërhoqa sa më afër dritäres për të parë bukuritë që dora e pranverës i pat thurur botës.

Por sa çela fletët e dritares një erë e freskët dhe e pastër mbushi mëlcitë e mijë. Ishte një ditë e bukur; në qiel pika reje; dielli fytyrqedhur lëshonte shigjetat e tij të zjarrta e për mua më duket se zgjidhte më të mirat. Së largu dukeshin fushat e gjelbërtë, që i shëmbëllën n jë qili mi të punuar me aqë mjeshtëri, sa që edhe dora e shkathët e Dianës, perëndeshës së artit, nuk do të kishte mundur ta endëte bukurinë pa fund!...

Porse unë isha têrhequr më fort prej lëvizjes së shpejt dhe shurdhuese mëngjezore që zhvillohesh në rrugë; i thëthitur prej kësaj lëvizjeje nuk kuptova se si kaloi koha kur ora lajmëroi 6 1/2. U hodha përpjete dhe me një herë fillova nga punët e zakonëshme të mëngjezit e pastaj përsëri në dritare. Vështrova njerëzit që shkonin e vinin. Secili shkonte në punën e tij, ku do të rrinte për një kohë të gjatë. I futur në këtë varg mendimesh nuk u vija re pemëve me rrobët e tyre të bardha e të kuqe qepur për bukurë prej pranverës; nuk ndjenja erën e këndëshme që përhapnin ato pemë në ajrin e vallzuar nga zëra zogjësh. Asnjë përshtypje s'më bënин këto bukuri, në të cilat më parë kaloja orë të tëra. Vetëm shifja me vëmëndje një kreaturë që vuan për kreaturat e saja, një mëmë që përpinqet për fëmijët e saj; një dallëndyshe që punon për të vegjilit e saj: përcante me krahët e saja delikate ajrin, mblidhët, në një vënd të përshtatshëm të një strehe landët dhe bënte një gerdhe. Edhe ajo punonte e vërtetonte fjalët e Naimit; «Punë, punë natë e ditë, që të shohim pak drithë».

Përnjëherë më rrethuan shumë mejtime e unë notonja në to.

Të gjithë, edhe mizat përdheske, punojnë e unë rri si përtac. Nuk kujdesem aspak dhe tash së fundi kam filluar të mos bëj as detyrat e mijë, kurse të tjerët punojnë e nuk lodhen. Mua puna më ngjan e mërzitëshme, ndërsa dallëndysheja e vogël punon me gaz. Unë s'bëj tjatër veçse shkaravis tri a katër fletë të shkreta, kurse të tjerët bëjnë punë të rënda... Turp për mua!...

Atëhere, duke e njobur fajin tim, vajta, mora librin

e mësova me zell deri sa u dola në krye mësimeve të asaj dite.

Pastaj vura librat e mijë në çantë, ora binte 7 1/2,
e shkova në shkollë.

Isha i kënaqur prej vetes sime, sepse njoha fajin
tim dhe mësova mësimet. Të falnderoj edhe një herë, o
dallëndyshe e vogël, që më zgjove nga gjumi përtacuer!

*Botuar për herë të parë
në «VATRËN E RINISË», 1935*

PRANVERA

*I bukur është qelli,
Dëfryese era,
Sa i ëmbël dielli,
Erdhi Pranvera.*

*E bukur natyra,
E ëmbël pérhera,
Të këndëshme ngjyra
Erdhi Pranvera*

— Ja! Cicërim dallendysheje! Erdhi Pranvera!
Ja një frazë e këndëshme që kënaq veshët tanë në
këto ditët e para të stinës së lulevet.

— Gëzohuni fëmijë, se ardhi pranvera!
U largua të ftohtit e mërzitshëm që na strukte.
Kaluan tre muaj të këqij, të plogët e të mërzitshëm.

Pranvera me shkëlqimin e saj e trembi dimrin
përtac, i cili iku i tmeruar. Rretë u shpërndanë dhe dje-
lli jetëdhënës u shfaq e mbushi gjithkënd me gëzim.
Lulja zgjati kokën e saj me kureshti e, kur pa se dimri
i egër ishte zhdukur, u ngreh, u krenua, nxori konxhën
e fryrë, zbuloi petalet e bukura, ndërsa bari i shtroi
tokës qilimin e gjelbërt pranveror. Manushaqja zgjati
kokën që prapa ferrës, dëgjoi këngën dehëse të bilbilit,
dashnorit të përvëluar, u skuq e u fsheh e turpëruar
krahëshkruar e bleta e bekuar puth me një zjarr, që
vetëm të rïjt e kanë, lulet e bukura që si yj ndriçojnë

mbi lëndinën e bukur. Së largu ndihet zhurma e par-mendës mbi tokën e begatëshme për të nxjerrë nga kra-hruari i saj bukën, lulen e jetës. E hundët tona përkë-dhelen nga zambaku i bardhë, trendafili i bukur, kara-fili ngjyrë gjaku, kamelia vogëlushe, mos më harroja e dashur, manushaqja modeste, borziloku erékëndëshëm, meneksheja e artë, e nga lulet e tjera të bukura me të cilat natyra ka prikosur pranverën.

Gëzohet bariu se dhënt' e tij po shtohen; mbushet me qejf bujku se erdhi koha e tij. Pranvera kudo kë-naq, kudo gëzon e ngazëllon; ajo është gëzimi i fëmijë-ve, kënaqësi e prindërvet e shpresë e pleqvet, është e lehtë, e shkathët, punëtore si rinia.

Të përshëndes, o pranverë e gëzueshme, o stinë që përtrin jetën duke përhymnuar të mirat e tua!

*Botuar në «VATRËN E RINISË»,
3 maj 1936*

P A S H È ...

Pashë një èndër kur gjumi ndehu krahët e tij të zës mbi trupin tim të raskapitur...

Pashë një lypës të shkretuar e të reckosur që trokiste me qëndresë e durim në një portë t'artë; dridhesh, derhtë lotë, gjak, vrer hidhërimi, të një hidhërimi përzjerë me shpresën qiellore, shpresën e uruar, dhuratën hyjnore më të çmuar e më të bekuar Dhe jehona e zërit të tij, të mekur, të shuar më bëri të më shkojnë moronica...

O Zot! Gjer kur vuajtje, gjer kur vaj e lot' e zi?! O jetë! O Hamlet, princ i mjerë, ngreu, ngreu nga varri, se vetëm ti di të gjesh cilësorë të përshtatëshëm për ata që vuajnë e që s'kanë prehje!...

E pashë e një kujdes, një merak i madh më pushtoi: A do të marri përgjigje i varfëri lypës?... A do të çelet porta e artë?...

Dhe u zgjova përnjëherësh e mendova thellë, thellë: lypësi, në lecka, i drobitur, i neveritur, i mjerë që dergjesh para portës së artë s'ishte gjë tjetër veçse zemra ime e çpuar tejtej prej shigjetave të zjarrit të kësaj bote; dhe port' e artë ishte zemra e jote, hyu i jem, zemra jote, gjithnjë e freskët, e ëmbël, plot gaz, plot hare!...

Dhe duke menduar gjithënjë në mes të heshtjes së dhomëzës sime pëshpërita: «Kur do të hapet, vallë, kjo zemër e freskët sikurse një trëndafil i porsaçelur?... Muri më ktheu ftoftazi ushëtimën e kësaj murmuritjeje... Askush nuk m'u përgjegj dhe lotova hidhur në heshtje...

K U R . . .

Kur shend e verë hyn në folen tënde, dallandyshe, lëre zemrën e vockël, që ka shpërndarë tërë d'itën gëzim e hare, lëre të bukurën zemër të endet e të endet, të kalojë rrugë, të kapërcejë praqe e të arrijë më së fundi në dhomëza e ime e shkretë që e ka plakosur një trish-tim, një lot, një psherëtimë! Lere zemrën tënde, vogë-lushe të thuri një qark të vogël rrëth zemrës sime për të ndjerë se me ç'hov rreh kjo e gjorë, me ç'furi përpinqet në krahnorthin tim të drobitur, të munduar, të djegur, të përvëluar; lëre, o ëngjëll, për një çast zëmrë-zën tënde mbi këtë timen, të varfër! . . .

Kur plot gaz kthehesht në folen tënde, dallandyshe, lëre mendimin tënd të fluturojë e të fluturojë gjer sa të kapërxejë mure, kanxhella e të arrijë këtu pranë meje, të më gjejë këtu, të zhytur në këtë pellg të zi dësh-përimi ku unë notoj e përpinqem të shpëtoj, o qiell! O dhe! O jetë! O vuajtje! . . .

O dallëndyshe krahëflutur, lejoje për një çast të vogël gjykimin tënd të mprehtë të vëreje me gjakftohtësi këtë gjëndje:

«Është një zemër që rreh, dy sy që vajtojnë, një kraharuar që psherëtin, një shpirt që vuan. . . Dhe s'e meriton këtë vuajtje, o dallandyshe e vogël që aqë shumë të adhuroj. . .»

«Gjer kur kështu!. . .»

«Përse hesht!. . .»

«Mjaft — më!. . .»

KENDOMË, MOTËR!

Këndomë motër, ashtu ngadalë, me një zë të ngrohtë e t'ulët që di të përqafojë zemra.

Ja dritat një nga një u shuan. Një qepeng krisi, u ul, vdiq. Dha shpirt së largu një zhurmë, një ulërimë. Qetësi prej varri.

Por jo tani heton nata, nata e tërë që po na hyn tinëz në gji. Janë ndezur yj në qiell e po pëshpërisin poezi dritash. Gjallon një natyrë e tërë, zgjohet si një èndër, e mbledh e tret gjithësinë. Misteret e botës kërkon të zbulojë qielli i mahnitur e Mëm' e dashur me gjirin zërthyer sodit kufijt e eterit.

Këndoma, motër, këngën e yjve që pëshpërisin; i ndëgjon të rrahuat e bujevet të tyre, zemrat e tyre nuk i sheh. Kjo natë që mbuloi çdo gjë në errësirë shumë mistere po na zbulon.

Këndoma këngën e etertë të rruzullimit, motër e vogël, e tregomë a kanë fund shkretëtirat e ftohta të tij; ai i ka të panumurt oazet që një lëvizje — dashuri i mbush me jetë. A çdo gjë në to është e pakufishme si zemrat tonë këtë natë?

Këndona një këngë për këtë të dashurën mëmë natyrë që po na çel sonte gjinjët e saj qumështorë: pini bijt e mi, pini doli e dashuri; qofshi të bekuar. Sonte a s'e ndjeni, o motër, që të dy po na mban në preh e po e ndjejmë të rrahi zemra e saj pranë sonës? Foshnjat qetohen në gji të mëmës. Prandaj një qetësi na ka rehatosur zemrat.

Të këndojmë pra ashtu ngadalë; një jetë e tërë po këndon.

Ashtu ule kokëni mbi supin tim. Por mos fli, shekuj me radhë kemi fjetur. Sonte duhet të rrimë zgjuar. Diç po na premtohet. E sheh yllin e mëngjezit që ndrit? Duhet të shpresojmë. Pra, mos dërmit. Nëma dorën. Kështu të qetë edhe pa nxjerrë zë e dëgjojmë këngën e re, matanë natyra po këndon.

Tani shife atë që na kish premtuar lindja: një dorë e trëndafiltë po rrëmbejn yjtë një nga një. Nata po zbehet: ora e saj trokëlliti. Natyra po merr jetë të re. Ka për të lerë dielli, natë e dashur.

Të brohorasim, o motër. Natyra ka për të marrë jetë të re, ka për të lerë djelli!

PASHË NJË ËNDËR

Porsa që gjumi, me këthetrat e tija të rënda mbi qepallat e mia, më mbuloi me krahët e tij të errët e të paralizuar si të vdekjes (ndonëse vdekja krahët i ka krejt të zes e krejt pa ndjenja), pashë një ëndër. Kur qeshë krejt i qetë e kur asnje organ i trupit tim nuk lëvizte, përnjëherë u tremba, përnjëherë u hodha prej shtratit, se pashë një ëndër...

Pashë një ëndër si shohin të gjithë, por në atë ëndër, që pashë, pasqyrohej jeta e ardhëshme, jeta plot vuajtje që na pret, në qoftë se asnje ndryshim rrënjosor nuk i ngjan jetës sonë. Pashë një ëndër që ndonëse që një ëndër, la gjurmat më të mëdha se gjurmat e çdo realiteti, se n'atë ëndër dukesh gjëndja e ardhëshme e jetës, në qoftë se s'ka për t'iu vën fre kësaj udhe që ka marrë bota. Ndonëse pashë një ëndër, pashë jetën vetë. Pashë se në ç'gjëndje do të arrijë bota sikur të vazhdojë t'ecë kriza me këto hapa vigane që po ecën. Pashë deri në ç'pikë do të arrijë dëshpërimi, sikur të vijojë kështu; megjithë atë, s'pashë gjësendi tjetër, veçse një ëndër.

.

THA PERËNDIA . . .

Tha perëndia:

Gur, ti je aqë i fortë, që vetëm një gur tjetër mund të tē thyejë (se ahere veglat e metalit s'kishin dalë). Do tē tē fal hidhërimet e vuajtjet, mbasi ua dhashë tē gjithëve e asnje s'i duroi. O Gur, krijesa ime, duhet ta pranosh këtë dhuratë hyjnore. Pse stepesh? Pse ngurron? Unë dua kështu e kështu do tē bëhet.

Tha Guri;

Lavdi Pushtetit tuaj, o Zot i madh! E rëndë është barra që më jepni, por si një shërbëtor i bindur duhet ta pranoj.

Dhe ashtu u bë. Guri mori mbi kurrizin e tij hidhërimet e vuajtjet. Por a i duroi dot se!... Pasi kaluan ca kohë, i tronditur e i krrusur deri në palcë, i shtypur e i rrëgjuar si mos më keq, i lodhur e i raskapitür, plasi. Ai gur i fortë, aqë kryelartë, ai shkëmb që çante tallazet e shkumbëzuara e shpërndante frashinë e furrishme, që u priste udhën revet tē dëndura e rrufevet gjakatare, nuk duroi dot.

— O Zot, nuk duroj dot më! — tha.

Dhe Zoti, pasi gjykoi mirë, i tha Njeriut:

— Njeri, krijesë e dashur! Për hir tē dashurisë së veçantë që unë kam për ty, pranoje këtë dhuratë, sado që s'është dhe kaqë e mirë.

Dhe njeriu pranoi.

Që prej asaj kohe kaluan shekuj e shekuj. Njerëzimi përparoi, por barra mbeti po ajo. Njeriu fluturoi si zog, kaloi dete si peshk, çau kanale e tynele, ndreqi pa-

llate e rrugë, por vuajtja e ndoqi kudo. Pranë një pallati është një kasolle, pranë një automobili është një këmbëzbathur, pranë një lordi është një i uritur. Sa lot e sa gjak e ka njomur rrotën e jetës që vazhdon të sillet qetësisht e vazhdimisht. Dhe njeriu, kafsha më delikate, duron dhe duron. Por, vallë, a do të durojë gjithënjë? Njeri është i lumtur, tjetri vuan, dikush këndon e dikush tjetër qan. Por a do të vazhdojë kështu? A do të vijë një ditë që njeriu të dali e të thotë:

— Mjaft më!... U lodha së hequri në këtë botë të gatuar me lot!

Të gjithë e rrëfejnë këtë legjendë në anët tonë, por askush s'ja di fundin, mbasi nuk ka mbaruar ende. Thonë se njeriu do të shpëtojë, pabarazimi e vuajtja do të zhduken... A ta besojmë?

ZËMRA E ATDHETARIT

Zbriste në rripa ë ë përrej, ngjitej me guxim në male, hynte pa frikë ë ë pyje, e quante veten trim. Kish-te fytyrë të gjërë, ballë të hapët, sy tejkqyrës, flokë të gjata luanore, mjekër të hijëshme e me një fjalë pamje trimi. Kur të shifje shpatullat e tija të gjëra e krahëro-rin e fryrë, kur të shifje ë supin e tij atë mauzer mizor e rreth belit të tij të hollë atë gjerdhan fishekësh, do të kuptoje se përpara teje qëndron një trim. E me të vërtetë, ay trup vigan, ajo fytyrë luani ishte një trim luftëtar.

Dikur ishte n'Amerikë, por, porsa ndjeu ëmbëlsinë e lirisë, dashuria e Atdheut filloi t'i zhuriste shpirtin, e më vonë nga kujtimi i foshnjërisë së lumtur ë fshat-thin e bukur, kjo dashuri iu flagëzua aqë tepër, sa që porsa mori vesh se ë Shqipëri u ngritën komitë, u kthyte me të shpejtë n'atë vënd që e lidhët me zinxhirë të fortë; u kthyte me shpresë që të vritej për atdhe...

Hëna ngjyrë mjalti, me një qeshje ironike ë buzët e saja të holla, u msheh prapa malit të Goricës për të mos e parë agimi, armiku i saj i përhershëm.

Yjt sa vinte veniteshin dhe zhdukeshin si të frikë-suuar prej agimit, që bënte të zbardhët dëbora e Tomorrit.

Dalngadalë malet filluan të trëndafilëzoheshin e të skuqeshin si rrobe e purpurt e ndonjë mbreti klasik; u verdhën, u bënë të florinjtë si gjethë vjeshte dhe më së fundi u bënë të bardha e të shkëlqyeshme ndën dritën jetëdhënësë të djellit që porsa ndehesh mbi çatit e Beratit.

Luani i malevet, Panterë e patrembur u zgjua. Nxori prej xhepit të gunës një flamerth, e puthi, e afroi pas zëmrës e e futi në gji; pastaj filloj të pshëritinte, të fliste me vete fjalë të zjarrta e, kur shpirti iu pushtua prej zëmërimit t'errët, bërtiti;

«O fat i pashpirt!... O padrejtësi!... O natyrë pa ndjenja!... O Perëndi, përsë nuk të vjen keq? (!)...

«Pse ky mosbarazim?... Tërë popujt gëzojnë liri, tërë popujt qytetërohen, vetëm ne!... Ah, të mallkuarët turq!...»

Era e egër malësore merrte fjalët e tija, ankimet e tija e i përcillte në çdo anë t'atdheut.

«Hapu, o errësinë e ndyrë, hapu! Shpérndahu, o pluhur mbytës! Hiqu, hije mizore e tiranisë! Çelu, o dritë e ëmbël e lirisë!» — pëshpëriste me dëshirë të flaktë.

«Por ç'flas?... A vetë do të zhduket errësira, kur asnjë s'luan vëndit?... Ku janë ata trima që ndaluan sulmet barbare, u bënë mburojë e Europës? Të gjithë për të tjerë? A s'paska asish që të kujtohen për mëmën e tyre?» — thërriste me dëshpërim.

I përgjigjej zemra e tij:

«Jo! Mos e shif botën vetëm së prapthi! Ktheje edhe nga e mbara!»

«Sa barij gërvishtin tokën me krabën e tyre e shkronjës shkronjat e shenjta që ti u mësove?

«Idetë që shpérndave ti kanë formuar me mijë rrëke që sot vazhdojnë rrugën, duke u ndezur e egërsuar më tepër, kur gjëjnë rrugë e pengesa; këto rrëke më vonë do të bashkohen e do të formojnë përrenj të pandalueshëm, prej bashkimit të të cilëvet do të formohet lumi i madh i kryengritjes, që, së bashku me të tjerë lumej të formuar prej shokëvet të tu, do të përbëjë detin e lirisë e të pavarësisë kombëtare.

«Pyet Dodonën e do të të përgjigjet kështu.»

* * *

Befas, prej gurgullimit të përroit që zbriste rrëmbyeshëm përpëra tij, dualën disa hije të bardha e zunë

të vallzonin e të përhapnin në ajër aroma dehëse e jehoma madhështore këngë.

*Gëzoju, Shqipëri, se djem petritë ke!
Djem Sokola mali, trima të pavdirë,
Q'derdhin gjakn e 'tyre për liri e atdhe,
Që vdesin gjer më një, që të rrон' të lirë!*

Atëherë zemra e Atdhetarit u mbështoll fort, shpirti i tij u prek tepër e një oh i thellë doli nga goja e tij!...

Kur ndigjuan zanat këtë britmë të thekshme, u prapsën e vetëm pas disa minutash mundi t'i afrohej njera e t'i thoshte:

«O trim, trim i rallë, o fatos luftëtar! Pse të pshe-rëtish ti, o zémërluan? A mos iu trembe vdekjes?

«Nuk i trembem aspak vdekjes, se për vdekje kam dalë» — kumboi zëri i egër i trimit, — «por psherëtij, se ata sokola mali që dikur ishin tmeri i osmanllisë, sot janë në gjumë; të pakët janë ata që u kujtuan për mëmën e tyre, se shumica lëftojnë për të tjerë».

«Por atëherë, kur ti e di që në rrugën e atdhetarë-vet të pret vdekja me shpatë çveshur e kur ti e di se je vetëm e natyrisht do të vritesh prej saj, pse del atëhere malevet?» — gjegji zana me zërin e saj të naltë.

«Oh! po unë kam dalë me qëllim që shpata e asaj të hyjë thellë e thellë në zëmrën time, se duke vdekur unë do të marrin shëmbell të tjerët e me shumicë do të derdhen në këtë rrugë e atëhere vdekja s'ka ç'u bën, se janë shumë... Dua të vdes, zëmra e ime e kërkon!!...»

«Eshtë një trim' i rrallë», — tha një zanë me ëmbëlsi.

«Një atdhetar i flaktë», — shtoi një bukuroshe tjetër me adhurim.

E zanat u zhdukën.

Trim i ndënji pak i heshtur; pastaj nxori tejkëqyrjen e tij, vështroi, vreri vetullat e kaloi me hapa të rënda e, në vendin që mbeti i zbrazët, buçitën fjalët e tija: ja Liri ja Vdekje.

* * *

Së largu ndihen krisma të mauzerit mizor e trupi i viganit u rrëzua i shpuar në zëmër, ku aji dëshironte.

— G'gjau?

— Një përpjekje me patrullën.

* * *

Trimi kryengritës vdiq se ashtu donte zëmra e tij, atdhetare.

*Botuar në «VATRA E RINISE»
28 nëntor 1935*

NJË 475 VJETOR

26 prill 1451

Porsa djelli skuqi kupezën e qiellit e trendafilëzoi dëborën e Tomorit, zanat e bukura u zgjuan.

E bardha e Çukës tundi krahët e saj të bardhë, luajti pakëz vendit, çeli syt' e saj të bukur të kaltërt, si qelli i Arbrisë Kreshnike, pa shoqet e saja të zgjuara dhe përsëri pështeti kokën e saj mbi fletët e lajthisë. Aty poshtë, pranë burimit të bekuar prej Zeusit në kohërat magjike të mithollogjisë, poeti i aratisur i malevet, bilibili, këndonte i dehur prej bukurivet, që dora hyjnore e pranverës i thur natyrës këngën e embël të puthjevet të zjarrrta, që qelli i artë i jep gjithësisë çdo mëngjes e kjo e fundit i pranon ato puthje të mjaltëta, duke u skuqur prej turpit. Dhe e bardha mbylli sytë prej kënaqësisë dhe e zuri gjumi. Dhe kur po flinte iu duk sikur pa se kudo njihej gëzim, sikur kudo njerëzija brohorisnin të gëzuar; Rroftë Mbreti ynë trim, rroftë Mbretëresha bujare; iu duk sikur pa se kudo fisnikë niseshin kaluar e ngarkuar me kanisqe e dorova. Pa pleq të krusur prej vjetëvet e vuajtjevet, që për kaq kohë lëftuan e s'iу trembën vdekjes, ta qahin si foshnje nga gëzimi duke belbëzuar ngadalë prej rrahjevet të zemrës: Lavdi zotit që ja mbritëm kësaj dite të madhe; pa atje së largu ushtri që vraponin duke shkrehur armë e duke kënduar;

*Kush ësht' ay trim' i rallë
Që sulet gjith'një në ballë!
Është trimi, Kastrioti
Që për ne e fali Zoti,
Esht' i Madhi, Skënderbeu,
Me të cilin mburret dheu!*

Dhe zana e sheh atje tek prehet me leshrat e mëndafshëtë mbi krahorin e bardhë e me gojën e trendafiltë të mbyllur ndofta për të mos iu dukur diamantet që fsheh aty mbrënda ajo gojë; i sheh e kënaqet me gëzimin e tyre, por zeri i bilbilit e zgjuan. Atëherë ndëgjon një këngë të bukur që i shëmbellën një kori engjëjsh; ngrihet me shpejtësi rrufeje në këmbë, ndërsa era ja merr flokët e artë, e len t'i duken mirë mollzat e kuqe. E Bardha e Çukës së Tomorit, ajo engjellushkë që pat parë të gjitha c'kanë ngjarë, që prej luftës titane nér lami-jet përrallore, që prej denimit të Prometheut, që ahëre kur Pellazgjét fisnikë u shtrinë nér viset e bukura të Ballkanit, fluturon e vetmuar prej asaj kenge, kalon përrej pa vënë re përshpëritjen e tyre e shkëmbejt, pa ndëgjuar bisedimet e nxehta që ata këmbenin me veriu e hollë, kalon Osumin e gjarpëruar, u flet kodravet rretherreh pér gëzimin e madh. Dhe gjendet ndërmjet zanavet që trondisin ajrin e sheshit të bukur me jonet e këngëvet të tyre magjiplotë, duke kënduar ato, këput lulet që pranvera i rrit me përkëdhelje e puthje. Trëndafilat e kuq si gjaku, që zbukurojshin kraharorin e adhurueshëm të Afërditës, dhe manushaqet e përvujtura, që aqë shumë i pëlqenin Dianës, gërshetohen në kunora, ndërsa margaritarë gëzimi rrrotullisen mbi mollza të purta.

Po ja, o motra, folëni, ju lutem, ç'ju bën të gëzoheni kaqë tepër? Dëgjova edhe unë pëshpëritje gëzimi, por isha i dehur prej muzikës. Folëni, ju lutem, që të gëzohem edhe unë si ju!

Dhe vashëzat pushuan këngën e tyre, kur Ora e Osumit u afrua e i folën së Bardhës Çukë të Tomorit e i folën me aqë hiesi:

— O motër fisnike, që freskohe nën lajthitë e pranë burimevet të shenjta! Vetëm ti nuk e paske marrë vesh se sot dhei i Arbreshit, i njomur me lotët e vuajtjeve, feston midis gëzimit ditën e madhe në të cilën trimi i trimave, fatos i fatosavet, mburrja e Europës, tmeri i barbarëvet, martohet me Donikën fatbardhe, fisnikën e Kanimës, bukuroshen e Epirit!

Dhe një zë i largët ua këputi fjalët, një brohoritje frenetike që midis tingullit të kambanavet ushtonte:
«Rroftë Mbreti Gjergj e Mbretëresha Donikë»!

Dhe Zanat filluan vallen e tyre.

— Mblidhuni, o motra këtu. Duke përhymnuar Kurrën le ta mbulojmë rrugën prej Kruje në Kaninë me lule.

— Atrope, tirua të gjatë perin e jetës Gjergjit të Madh e Donikës fisnike.

— Zeus, beko Lulen e Re që zbukuron Kopshtin Arbëror.

*Botuar në Nr. 3 të revistës
«GJYNAZISTI» në prill 1936*

17 JANAR 1467

Turma t'egra barbarësh kaluan shkretëtira, male, rripa, gryka, lumej; kaluan turmat e pamposhtura, duke kallur dermën kudo, e ngulën flamurin e tyre mizor mbi piramida eshtërash.

Dridhej Europa e tërë, kur mendonte se Turqit e pamposhtur po afroheshin; as mbrojtja luanore e Paleo-llogut, as ekspeditat e guximëshme të Hynjadit s'e pengonin dot afrimin e tyre të shpejtë. Por Zoti i Shqipërisë i preqatiti pragun e pakapërxyeshëm e Zanat e Tomorit për 24 vjet me rradhë kënduan trimëritë e bijve të shqipes që, të primë prej Skënderit petrit, përqëndruan turmat e qindra mijrash barbarësh.

— Zot, po s'paska një vdekje t'a rrëmbejë! — mallkoi Sulltani, kur pas 6 muaj rrëthimi, e la të lirë Krujën, pasi s'mundi ta pushtonte.

Shkoi Ora e dëgjoi nëmën e ligë. E vdekja e verbër preqatiti drapërin e saj gjakatar.

Plot 468 vjet mbushen sot prej asaj dite të tmerëshme. Sa lumtëri priteshin prej vitit 1467, aqë të këqija solli ky vit e shi këto të këqija i përmblodhi në mes të javës së tretë, e, pikërisht, më 17 janar!

Le të këthehemë 468 vjet prapa, le të qëndrojmë në Lesh, në atë çerdhe atdhetarije, kur më 28 Nëndor 1444 u mblohdh e famëshmja ligë, që vuri Gjergjin e Madh në krye të ushtërive të Shqiponjave... Le t'i afrohemë pakëz sheshit përpëra Kishës e do të shohim të sheshuar burra, pleq e të rinj të zjarrtë, të gjithë duke biseduar e një pyll majash ushtash duken mbi kokat e tyre. Një bu-

rrë i gjatë me një palë mustaqe të gjata, shetiste andej e këndej trimavet e fjalosej me ta. Dy të tjerë shtatgji-gantë shëtisnin e kuvendonin.

— Flitet që edhe Papa do të dërgojë përfaqësues.

— E besuarshme. Ti e din mirë, Gjin, se edhe Papa përpara këtij vdiq, kur do të vinte e të kurorëzonte Mbretin tonë të dashur «Mbret të Mbretërvet».

— Sidoqoftë kjo ligë do të jetë madhështore. Nesër vjen, më duket, i dërguari nga Napoli e pasnesër asgjë s'na ndalon ta çelim, Mojsi i dashur.

Mojsi Golemi e Kapedan Gjini u larguan e lanë të ndihet mirë kënga e malësorëvet.

*Luftoi Gjergji zog petriti,
Pallën sheshit seç e qiti,
Ballabanit iu afrua,
Iu vërvit porsi dragua,
Ngriti shpatën e i ra
Tradhëtarin n'vënd e la.*

E kur Mojsi Golemi bisedonte me Gjinin, kur Dukagjini këndonte me malsorët, kur Kont Urami me shokë preqatitnin pritjen e delegatëvet, i Madhi Skënderbej, i sëmurë pér vdekje, dergjej në shtratin e tij.

— Mjaft qave, Donikë e dashur! Pusho, zogthi im, pusho biri i ëmbël, se më copton zemrën loti yt! Afro-mu Gjelosh të tjet rap një porosi: lajmëro popullin e parësin se unë do të vdes...

— Oh, imzot! Ç'fjalë të hidhura nxjerr goja jotel Sa tmeruese janë ato fjalë pér familjen e atdheun tênd.

— Do të qajë Shqipëria, do të gëzohet armiku! Sa keq! Atrope, përse s'pret edhe pak kohë po nxitohe të presësh fillin e jetës sime?!!!... Gjelosh' i dashur, mos harro porosinë.

Kontët e Zotët u mblodhën të dërmuar nga kjo bombë e papritur. Dukagjini lajmoi trimat:

— He, burra! Gjëma më e madhe ka me mbuluem vendin tonë: hija e vdekjes i vjen rrötull Mbretit!...

Me shpejti rrufeje u përhap lajmi fatal, lajmi që tmeroi e dridhroi një popull të tërë. Vdekja me krahët

e saj të mpihtë mbuloi e paralizoi atë burrë të çelniktë, që tronditi për 24 vjet Turqinë e tërë. Miliona sy qanë, miliona zemra u zhuritën. Ah vdekje, vdekje!

Por kaloi dufi i vajit, se armiku afroi e të gjithë u munduan të përbushin dëshirën e fundit të Skënderbeut: «Qëndroni me flamurin tuaj sa të mundni». E trimat qëndruan burrërisht për 11 vjet, por më vonë u përkulën nënë turmat barbare që shkretuan e rrënuan këtë vënd, duke mbjellur farën e mjerimit e të prishjes në gërmadhat që lanë pas.

Berat 17.I.1936.

*Botuar në gazetën «DRITA»
7 maj 1961*

PËRQAFIM

«Shpirti ynë është nostalги për diçka gjithnjë më të bukur»

GOETHE

Një herë shpirti im hodhi gardhin, përtej ishte një lëndinë e gjelbër dhe e butë si një zemër bujku.

Dhe ja, deri më sot përgjumshëm, zgjohet nëpër vënde të panjohura ëndre, drite. Me një të puthur të kaltër e të përflakur e presin miturinë time vargje të lehta mirësie që burojnë nga çdo gjëmb e q'enden n'arë. Pëllumbat e bardhë dashurie, q'enden h'ærë, shpirtë të tjerë si i imi, takohen me mua e ngrohemi së bashku në një lumturi aqë të re, sa mëngjesi i jetës sime. Kishte lule të bukura e kroi këndonte!

Një botë e re, një agim i ri. Dhe ndënë zjarrin e këtij agimi të ri të gjithë pëllumbat e bardhë krah për krah e zemër për zemër formojnë trëndafilin e dashurisë; kungatë vëllezërimi njerëzish. Hynj në turmë e turma hyn në mua. Duart e mijas, duart e të tjerëvet, të njoma deri tani befas janë duar burri, luftëtarë për të mbytur një herë e mirë egoizmin, mjerimin, padrejtësinë. Gjej këtu pranë vëllezërit e vërtetë që kërkoi në qiej. Ndjej zemër njeriu të rrahi në krahanorin tim të ri e në këtë çast jetoj.

Njeri, o vëlla, po gëzohet bashkë me ty e bashkë me mua po qan. Të dy dridhemi në ligjerim poezish thellë njerëzore. Dëshira të heshtura prej shekujsh përmbushen për magji: jo më flori e lecka, jo më gjak e lotë.

Gjithësia është një hymn dashurie që na ngre në
qiellin e fuqisë prodhonjëse të përqafimit.

* * *

Ahere ëmbël-ëmbël fillon vallja e dashurisë: e tërë bot' e punës dhe e trandafilavet n'a mbush parzmen plot me një simfoni shati e me një parfum zemre. Shpërthen edhe nga gjiri im një këngë si në shpirtrat e tjerë dhe në një përqafim madhështor kënga shkrin këngët dhe e vetme e përgjithëshme i hap velat për n'hapësirën e pamatur. Këndoja unë? Ndonjë tjetër? Jo? Këndon jeta, dashuria.

Tani kënga eterizohet, përhapet, na fështjell, na depërtion, na rrëmbejn në ngrrohtësinë e saj. E ndjejmë të vakët nëpër dej, nëpër nerva, nëpër organë. Kuqëlin agimi, më ngjall një mijë akorde t'ëmbëla e të gëzuarshme. Afsh pranvere, na mbush me shpresë dhe me èndëri me të trëndafilita. Frymë lirie, na zgjon një zell brohoritës për të ndërtuar udhën e lartësimit. Përpëlitet në fund të vetes sonë një dëshirë e çuditëshme përtëritjeje, për të hyrë në një jetë më të gjërë, më të dëndur.

S'është më këngë: në këtë mrekulli që ngjan mrekulla e vetë krijimit, është një shkrirje shpirtërash që gatuajnë jetën, është jeta e tërë që gufon nga dheu kur vjen maji shpresëtar. Por ca më tepër është një flamur që na mbledh e na tret me natyrën-mëmë. Të gjithë tretemi në gji të gjithësisë e jetojmë në gjallërinë e saj, në bukurin'e saj, në harmonin' e saj. Ndjem po në një kohë i shpérndar ca këtu e ca këtej dhe i zoti të mbyll në gji tërë vëllezërit e mi, tërë ç'shoh për rrötull. Bota është mishi im, dehur me kalthërim; mendimi im është diell ngadhënjimtar i errësirës; fjala ime çfaq shpresat e gjeneratavet të tëra, gjithësi e tërë rron në ne. Një copë e lumturisë sime ruhet kudo, ndënë gjethë, në një fole, sillet me flladin, qesh me diillin.

Lindëm në një jetë krejt të panjohur e têrheqëse që zgjat në të kaluarën e në t'ardhëshmet përqafimin sub-

lim të gjithësisë së shkrirë në një copë të vetme, të ndijëshëm, të gjallë.

Ky çast është endër e bukur. Po për mua merr trajta realiteti dhe duke kujtuar jetën e mëparëshme: — Oh, se q'endër të hidhur paskam parë! — them me vete...

* * *

Dhe në këtë çast jete të vërtetë brënda në trëndafilin e dashurisë, në kraharorin e gjithësisë, në një dorë-dorë të hekurt të njerëzisë së lirë, më bie ndër mënt një kujtim i lashtë. Kujtohem unë? Jo! Kujtohet bota se unë si ti jemi bota. Më bie ndër ment një tufë, një kopësht, një zjarr...!

Befas kujtoj një tingull.

Është tingulli që i bënë bishat qëngja e njerëzit e shpellavet vëllezër. Ditët e mijë m'i ngroh si diell; është poezia m'e lashtë që na fisnikeron mbi kafshë të tjera, émbëlsi që kullon pikë-pikë e na jep jetë; tingull i thjeshtë si fyell bariu dhe energjie sa të shëmbi male. Depërton dashurinë për popullin dhe farë e natyrës dhe i rrëmben me vete. Nxit fuqinë e të bukurit e dëshirën e punës. Ngjall koncerте të harmonishëm ndjenjash e vargje të çthurur — këngëtorë, si liria.

Shkëputem prej vetes sime dhe me tingullin vërvitemi n'evolucionin kryengritës së bashku me sa na rrëthon për të përqafuar orizonte gjithënjë të reja.

* * *

Dhe pastaj, kur endra kaloi, kur më mbërtheu jeta reale, ky tingull më mbeti në gji. Herë-herë ndihet lehtë, thellë dhe për një herësh njeri, o vëlla, dua të të përqafoj me lot në sy.

*Botuar në gazeten «ZËRI I RINISË»
9 janar 1963*

D I T Ė V E R E

Cipa e errët e natës dalngadalë dobësohet e pas pak agimi zbardh gjithësinë. Për shegertët e gjorë u bë ditë, ndonëse djellit i duhet edhe ndonjë orë që të lindi. Rru-
ga, që më përpara kish renë në letargjin e heshtjes, merr përsëri gjallëri nga ato tufa djemsh e fëmijësh, që i drejt-
tohen tregut; një pjesë syresh qeshin e gëzojnë e të tjerrët duken si të hutuar se gjumi s'u ka mjaftuar; kështu
tufa të heshtura e tufa të qeshura, të gjithë kanë drejt-
tim; tregun. Është ushtrija e atyre djemvet e fëmijë-
vet, që, tamam në një moshë kur kanë nevojë për përkujdesjet më të mëdha trupore e mendore, hiqen prej
shkollave, ku më të shumtën e herëvet vazhdonin me zell,
dhe lidhen pas ustajt, tek i cili detyrohen të rrinë e të
shërbejnë 10-11-12 orë në ditë, është ajo ushtri e kru-
sur prej punës mjaft vjet para kohës; por, ajo që i bën
më pleq se puna e tepërt, është rrojtja e keqe dhe vár-
fëria. Çudi në këtë jetë; ata që rrinë pa punë ushqehen
mirë e rojnë të qetë, ndërsa ata që punojnë janë plot
me nevoja. Eh, kështu u kurdis kjo botë! . . .

Tashiti dyqanet janë çelur e shegertët me fshesë në dorë nxjerin të fshirat e bëjnë togje jashtë dyqanit. Kur djelli filloj t'i përshendesi me një mirëmëngjes të mjall-
tët me rezet e tija të para, filluan të vinin dhe ustalla-
rët e tyre.

Mbi një pezull dy fëmijë që kishin mbaruar punën po losnin lepurin, por, kur ishin duke qeshur me të madhe, një shuplakë e bën njërin të rrëzohet duke mprojtor me duar mishrat e faqevet dhe hundën e përgjakur. Ndërsa tjetri fërkonte veshët që iu hoqën me forcë. Dënimë shëmbëllor që ustallarët japid pa vendim gjyqi është

ky...! Ndérkaq fëmijët ngisnin pér tē mbushur ujë duke u ngjequr.¹⁾ A s'ka qđo fëmi nevojë tē lozi? Por jeta... ah!... varféri e mallkuar...!

Dhe një pas një kallijt e grurit priten, përkulen e bien përdhe pérpara drapërit katil tē kosëtarit; fëmijët e rreckosur mbledhin duajt, i lidhin e i shpien tek nënët e tyre që rregullojnë demetat. Gjithë fshati eshtë në lëvizje; kudo punë, kudo djersë, kudo vuajtje, kudo mundim! E tërë kjo punë, kjo djersë, kjo vuajtje e ky mundim kot: fara borxh, qiraja e pendës pér t'u paguar, pronari do tē tretën, fajdexhiu bën vizitën e tij më se miqësore i shoqëruar prej pérmbaruësit dhe tē gjitha këto shushunja s'ngopen së piri gjak. Po barku? Po fëmija? Po guna e shajaku pér në dimër? Po këpucët e llastikëta tē gomavet tē otomobilit që copëtojnë këmbët? Po kripa? Po vajguri? Me se do blihen ato? Me borxhe tē tjera, natyrisht! Halle mbi halle...

Me gjith atë ata s'flasin. Të gjitha këto u kalojnë nëpër tru por goja s'flet. Në mëndjen e tyre u paraqitet pronari i ngrysur që u kalon pérpara me kal, duke vënë re me indiferencë bujqit që i pérulen, qahjai duke rrëmbyer tē shumtën e prodhimit, frutin e mundimit të një viti, e më së fundi fajdexhiu i lik që fshin edhe ato që kanë mbetur. Pastaj truri i tij i paraqet si në një pëlhurë cinemaje skenat e vajtuarëshme tē familjes që vuau pér mveshje, mbathje, barëra e, ajo që eshtë më e tmerëshme, pér bukë. Por ndërsa truri i tij punon, goja hesht se i mjeri katundar eshtë mësuar tē durojë gojë-myallur sharje e martirizime.

Pakë më poshtë, në hijen e një mani, gramafoni ndihet i përcjellur prej një kënge tē gëzuarshme, tē dalë nga gojë femrash e meshkujsh. Eshtë një familje që ka dalë pér piknik në këtë katund. Ja, reth tyre fëmijë tē vegjël fshatarakë, që shikojnë me zili mishin e pjekur në hell, që eshtë vënë aty më poshtë. Ja dhe në rrugë kalojnë katundarë, që, kur shohin këtë familje tē këndojet me gëzim në një kohë kur tē tjerët vuajnë, s'kanë veçse një: «Ah! Botë, Botë!» në gojë.

1) qarje pa zë — nëndialektale beratase.

* * *

Djelli më rrëzët e tij të nxehta përvëlon trupat e rregjur të tyre, por ata shpejtojnë. Mesdita ka arrijtur dhe uria po u këndon serenata; me gjithatë ata ngasin e kjo i bën t'i afrohen bregut; është ora e mbritjes së varkavet; peshkatarë të tharë, plot rrudha e qime në trupin e rrjepur, u zbresin varkavet, plot ose bosh, të gëzuar a të dëshpëruar, për të qetësuar kapriçot e bar-kut. Dhe pasdreke të gjithë do të shkojnë në një shtëpi, ku gratë vajtojnë. Është ora për të ngushëlluar viktimën e asaj dite: se çdo ditë deti kërkon një kurban si shpërblim të peshkut q'u jep.

Ja dhe jeta e një pjese nga ata që vuajnë, jeta e asaj turme q'ushqehet prej detit, por më së fundi e ushqen atë; e atyre fshatarëvet e qytetarëvet, që për qiminter kanë detin e hapët, lakkimtarin e pangopur, ku-çedrën e kaltërt.

Ndërkaq edhe muzika, që nja dyqind metra më tej kënaqte ata që bënин banja në pllazh, pushoi për të filuar pasdreka.

* * *

Pasdrekë... Orët e vapës kanë kaluar. Disa gjatë këtyre orëvet kanë fjetur në krevate e disa kanë pësh-tetur kokën në hije të pemëve. Dyqanet kanë qenë të mbyllur dhe cirakët e gjorë gjatë këtyre orëvet janë dërguar në shtëpit e ustallarëvet, që të fshijnë koteçet e pulavet, t'u ndihin nikoqirevet në larjen e pjatavet ose të bluajnë në mulli ndonjë qase misri të transportuar gjer atje nga kurrizi i tyre.

Orët e mërzitëshme kanë kaluar. Të nxehtit ka filuar të pakësohet nga pak, pasi ka përbushur kapriçot e mesditës. Në zallishten e gjërë skelete të gjalla zbresin nga rrapishtat, ku pushonin, e nisin punën e tyre të rëndë me kokë kundrejt rrzevezet pjekëse të diskut të zjarrtë. Disa me kazma, disa me lopata, disa me tezga e disa, duke mbajtur në kurrizin e tyre trarë e

dega të rënda, punojnë që të këthejnë lumin. Oh, me sa èndje do të punonin ata të mjerë, me sa dëshirë do t'i turreshin punës sikur të mos i mundonte një gjë; pasiguria; ata përveç që ushqehen pakë, flenë keq, rrojnë si mos më keq dhe orvaten pa pushim, nuk dijnë në do të kenë të nesërmen punë, bukë, jetë. Me gjithatë ata duke menduar hallet punojnë e vuajnë në heshtje si gjithë të shtypurit në këtë botë. Dhe që në rrëzë të një shelgu i vështrojnë dy sy të pashpirt; është sipër-marrësi që i kqyr duke llogaritur fitimet e tij të rrjedhura nga eksploatimi i egër i fuqivet t'atyre. Dhe në disa shtëpira, aty afër, ende s'janë ngritur nga gjumi, perdet janë të ulura; në disa të tjera të rij e të reja humbasin kohën në tualetë e në disa më tutje po këndojnë pa i hedhur ndonjë vështrim kumsallës; eh, si të thuash, u rregjën së pari fatkeqësi... .

* * *

'Orët kalojnë indiferente njëra pas tjetrës. Rruzulli djellor tani ka zënë të zbresi duke u rrukullisur drejt perëndimit. Disa zonja elegante i drejtohen lulishës për shëtitje: disa intelektualë me syze — natyrisht të ngeshëm — u shkojnë pas; disa fëmijë, për t'u argëtuar venë edhe ata andej; kështu pakë nga pakë tërë të ngeshmit janë në shetitje.

Ja, aty tej një pëllumbth' i bukur pesë a gjashtë vjeçar po ndjek një flutur; një i reckosur, moshatar me të, e sheh me admirim; e ka zili për rrobat e bukura, për këpucët e vetëtitura, për kapelën e re e për bukën me marmalladë që ka në dorë, dhe i afrohet; të dy engjëjt zënë miqësi. Por një zonjë, ulur njëzet hapa më tutje, ve binoklin e artë në sytë e i vështron; «Albert», — i bërtet të birit, «— eja shpejt këtu!», i vogli shkon atje e shoku i varfér mbetet vetëm; ajo diç i thotë të birit e ai duke vënë gjishtin në gojë vështron shokun dhe pastaj ulet pranë s'ëmës. Por i vockeli rreckaman e kuptoi; ajo grua i tha të birit të mos rrinte me një të rreckosur, se ishte turp; duke menduar kështu veshtroi

rrobet e tij dhe një lot i pikoi nga syt e u rruckullis në faqet e tij të verdha. Ngadalë u tärhoq në një cep rruge pa bërë zë, duke menduar tërë ato të mira që pa. Dhe në mëndjen e tij i paraqitej pyetja: «Po pérse, o perëndi, disa të kenë aqë sa të mos kenë se ç'ti bëinë e unë të ha këtë bukë të thatë që më çpon grykën?». Dhe ndërsa djali shikon me urrejtje atë copë të ftohtë triditëshe, perëndia hesht: ai s'ka kohë t'i përgjigjet një të varfëri të neveritur nga njerëzia, nga jeta dhe nga ai vetë! Dhe dhëmbët e njomë vazhduan të brejnë bukën e thatë. Njerëz plot kaluan andej, por askush s'e vuri re fëmijën e njomë! Eh, kush kujdeset pér një rreckaman! Se mos ishte i veshur bukur që t'a përkëthelijn gratë e t'i buzëqeshnin burrat! Ah, jetë, jetë!!!!

* * *

Djelli perëndoi duke skuqur orizontin. Pak nga pak nata pushtoi njerëzinë me krahët e saj të zes. Atje në një kafe dansi vazhdon. Para një cinemaje janë mble-dhur një tuf fëmijësh dhe èndërojnë sikur të kenë një lek e të hyjnë. Më tutje në një pjetore një punëtor pi pér të haruar hallet. Në një shtëpi aty afër disa fëmijë po qajnë e në një tjatër po këndojnë. E kështu kalojnë orët e mbrëmjes; pastaj rrugët fillojnë e boshohen se të gjithë mblidhen në shtëpit e tyre; dritërat zënë të shuhen njëra pas tjetrës dhe zhurma të pushojë; vetëm në taracën e një shtëpije madhështore, që sundon një pjesë të qytetit, ndihet zeri i radios. Por pas pak asnjë zë s'pipëtin; disa lipës i ka zënë gjumi në cepin e një rruge, por një polic nate i dëbon e ata ngasin nëpër errësirë që të venë të flenë në qetësi jashtë qytetit...

Dhe kështu kalon një ditë verore e ëmbël pér disa të egër, pér të tjerët ikën që t'i lerë radhën një dite tjetër të njëllojtë me të...

Ah, jetë mizore! Ah padrejtësi e ligjëshme!...

*Botuar në revistën «BOTA E RE»,
15 shtator 1936*

*

LLAMBI . . .

Ato ditë punoi më me gëzim se ngahera. Pikë loti nuk derdhi as kur u gjend fill i vetëm e as kur e zonja e mallkoi.

«Llambi» — e thërritën, «Lepe» — u përgjigj si fluturimthi. «Kështu të bësh» — e porositën, «Peqe» — u përgjegj dhe fluturim në punë. Dhe kudo u bind: cikriku i pusit iu duk më i lehtë se ngahera, pazari më afër, puna më e kollajëshme. Sa e kishte bërë të lumbatur ajo fjalë që i kishte thënë xhaxhai te bishti i urës: «Do të të vijë mëma sot!... A ka fjalë më të lezetëshme se kjo! Oh Zot! Por a ka më lumturi?!

I shkreti Llambi! Nisi të kujtojë të shkuarën. Ato kujtime të përmallëshme që ja çojnë peshë zëmrën e tij të njomë e ja fryjnë kraharorin e tij të vogël.

Ishte i vogël ahene. E ëma e merrte në gjunjë kur kthehesh e lodhur nga arat ku i kish ndihur të shoqit dhe e përkëdhelte. Ai e zinte përqafe me doçkat e bukura dhe i puthte faqen e saj të verdhë e të rrudhur nga puna e mundimi. Dhe ngandonjéherë mendonte: Pse mos të jetë edhe mëma ime e bukur dhe e shëndoshë? Dhe i vinte plasja. Por gjene të ëmën e donte, në të gjëntë engjëllin më të bukur që ëndëronte. Ai vështrim e ajo buzëqeshje me ëmbëlsi magjike ja ndiznin dëshirën përt a përqafuar dhe përt a puthur...

Llambi i varfër duke u mbështetur tek varrica e druvet mbylli sytë. Zemra ju gudua dhe sytë i diqnin si prushi; e kuptoi se po i afroheshin lotët dhe, me që kishte vendosur të mos qante atë ditë, e hoqi mëndjen nga ai kujtim e e solli në kujtime më të reja.

Ishte andej si ndonja tetë vjetësh... Kështu i kish thënë mëma mësuesit kur u regjistrua. Deri atëhere kurrë s'i kish vajtur në mënd se vitet shkojnë e njeriu rritet. Ai kishte bredhur e lozur arë më arë e vënd më vënd, pemë më pemë e degë më degë, kishte ngrehur gracka e kish ndrecurr qerika. Tashti e ndjente veten të

Bisedimet e prindërvet, kur shkoqnin misrin, i dëgjonte më me vërejtje. Të gjithë ata i përshkronin keq, oh sa keq! Borxhe, halle, uri paralajmëronin. Dhe Llambi habitesh.

Një ditë i ati i tha se duhej të pajtohej në qytet për të shpëtuar vëllezërit e tij. Ahere Llambit nga një anë i erdhi dëshirë për të vajtur te të vëllezërit se ja kishin shpurë në qzell qytetin, por nga ana tjetër shkolla i pëlqente dhe veç asaj kasollja, arat, drujt... Sa e keqe është ndarja nga vendi lindor. Pastaj prej vëllezërve e motrës nuk i vinte mirë të ndahesh e sidomos nga mëma. Oh, si e mbajti dot vendimin i vogli Llambi. Lot të xhevahirtë ja zburuan sytë.

Pastaj çuni filloj të kujtojë ndarjen e lot të tjerë i kulluan mbi faqet e tij.

Asaj dite ishte shumë i brengosur, thua se i ishte këputur ndonjë copë prej shpirtit. Lot të ngrohtë derdhë sa herë që shihte se s'e vinin re të tjerët, se kish turp ta shihnin të qante.

Pastaj kujtoi çastin e pjekjes e lotët i vanë çurk.

— T'u mirë mbeç nëno, — i kish thënë s'ëmës duke kafshuar buzën për të mos lotuar.

— T'u mirë vafsh, biro, dhe mos m'u sëkëlldis, kurban i nënës, — i ishte përgjigjur ajo me një buzëqeshje në të cilën çdo njeri do të kuptione se fshihej një dëshpërim, një lot, një vrer i hidhur. — Po bëj një kryq tek ikona — shtoi pas pak. Djalthi u fal, duke mërmëritur midis lotëve e ngashërimit që s'e linte... Edhe mëma kish shami në sytë, dhe fëmijët e vështronin të habitur. Në këtë kohë Pepi, më i vogël, pushtonte gjunjët e s'ëmës. Llambi puthi me dashuri turirin e tij të kuqur nga bredhja dhe pastaj u nis me t'anë. Te e kthyera e kodrës

vështroi edhe një herë me sy plot lot shtëpin e tij, e ëma e të vëllezërit ishin në oborr duke ndjekur me sy udhën e tij.

Atë ndarje e kishte kujtar çdo mesditë kur ngelte vetëm e kështu çdo ditë kish derdhur lot; kështu pra edhe këtë ditë, por këtë ditë nuk duhej të qante se do t'i vinte e ëma; prandaj fshiu lotët e doli te porta për ta pritur.

* * *

Pas ndonjë gjysëm ore ajo u duk në fund të rrugës. Kraharuari i vogël i Llamb'it u fry shumë e zëmra gadi sa s'ju këput, u värsul, e përqafoi, e puthi e qau e qau aq shumë sa nuk e nxori dot, zëri iu shua fare. Pastaj ndënji pranë sajë, i mori dorën, ja shtrëngoi ndërmjet duarve, ja puthi e ja njomi me lot. Një shpresë e bënte të gëzohej. Shpresa që e ëma t'a mirrte me vete.

N U R I J A

— Nurijel! Nurije!

Ky zë më sgjon çdo mëngjes posa rrrezet e para të diellit puthin dritaren time.

Këtë zë e dëgjoj çdo mbrëmje, kur qëpallat rën-
dojnë mbi sytë e mi.

Sa herë dëgjoj zërin e egër të fqinjës, të shqiptojë
atë emër, më vjen ndër mënt Victor Hugo: Nurija ësh-
të Kozeta e lagjes s'ime.

Në mëngjes shpejt Nurija del nga shtëpia e fqinjës
duke përpjekur këmbët e saj të zbathura mbi tokën e
ngurosur prej të ftohtit pér të nxehur kërcinjët që i
dridhen. Në mbrëmje ose natën del prej shtëpie pér të
mbaruar ndonjë punë që e ka harruar ose s'ka mundur
t'a kryejë ditën. Nurija punon çdo çast dhe s'është e
lirë as një herë.

Një natë m'u desh të dal prej shtëpisë. Me të dalë
u trondita prej një kërcëllimi dhëmbësh; ktheva sytë
dhe pashë Nurijen që dridhej.

— Pse përjashta, vajz' e mbarë? — e pyeta.

Ajo nisi të qajë.

— S'më qas zonja; më ka dënuar të fle jashtë, —
tha në mes të ngashërimeve që s'e linin të fliste më
gjatë.

— A është përsëritur tjetër herë ky dënim? — e
pyeta prapë si e futa në shtëpinë time.

— Shumë herë, shumë herë, e shkreta unë — pësh-
përiti ajo. Një pshëritimë e thellë që shoqëroi këto fja-
lë më preku tepër.

— Humba dy lekë, — tha ajo pas pakë — dhe pran-
daj më dënuan.

Nurija s'është veç se shtatë vjeç.

Me gjithatë shpejt, shumë shpejt, ngrihet fshin, mbush ujë, lan enët dhe shkon në pazar. Çikriku i pusit ndihet kurse unë shtrihem si përtac në shtratin tim të butë; mendoj duart e saj të vogla, që i ka kuqur e trashur të ftohtit, të kapin e të lëshojnë çikrikun; mendoj kovën e rëndë të derdhet në teneqenë e madhe të vajzës, e cila lëviz me të shpejtë këmbët e saj për t'i mbrojtur nga pikat e ujit; mendoj më së fundi Nurijen e vogël të krusur me dy teneqe aqë të mëdha, sa as unë s'i ngre dot: ngjan si një plakë shkurtabiqe me sargji përpara, me fytyrë thatanike, në të cilën të dy sytë i ka të futur; me një shami të rreckosur mbështjellë sido kudo rrëth kokës së saj. Kur unë shkoj në shkollë me jakë të ngritur, për të mbrojtur veshët nga era e lumit, e takoj atë që këthehet nga tregu duke u dredhur e duke u munduar të futë duart nënë pallton; por palltoja e së mjerës është më tepër rreckë se sa pallto. Emri i saj më përcjell çdo mbrëmje kur vete të fle; e mjera vajzë do të flerë ndonjë orë pas meje në ndonjë rrugos të ndehur mbi shtresën e ftohtë të tullave.

Nurija s'është veç se një ëngjëllushkë e pafajëshme.

Moshatarët e saj qeshin, lozin, dëfrenjë; ajo i shikon së largu me frikë se mos e sheh e zonja dhe i bërtet; — Mos vështro andej këndej, shtrigë, po veri mëndjen punës! — I sheh shoqet e saja kur shkojnë në shkollë dhe tëndëron të jetë nxënëse, ta dojë mësonjësia e ta përkëdhelë e ëma për notat e mira që do të fitojë.

Një ditë mori në duar me ngadalë librin e bijës së zonjës së saj, me kujdesin e një nëne për foshnjën e saj të njomë, po ajo e pa dhe lajmëroj t'ëmén, e cila i bërtiti aqë fort, sa i ra libri prej dore mbi një legen plot me ujë; mjerë kurrizi i Nurijes së ç'pësoj atë ditë!

Një ditë tjetër qëndroj në rrugë për t'admiruar një tufë vajzash të vogla, si ajo, që këndonin e losnin valle të zëna dorë pas dore, po i zoti e pa dhe i hoqi një shuplakë aqë të fortë, sa që vajza e mjerë ra përbys mbi rrugë.

Ditën e Bajramit e pashë që kishte mbuluar fytyrën me të dyja duartë dhe qante; ndofta se shihte shqet e saj me rrobe të bukura ngjyra ngjyra që ngjanin si flutura, dhe veten e saj trokë e thërime; ndofta se don-te të vinte në shtëpinë e saj pranë prindërve... Po vallë, a kishte prindër?

Iu afrova.

— A ke nënë ti, Nurije?

— Posi s'kam! — më tha duke ngritur syt' e saj plot lot, ata sy fëmije që dukeshin edhe të bukur me gjithë se të futur thellë në gropat e tyre. Kam nënë e baba: kam vllerzë e motra.

U trondita dhe bëra një çap prapa.

— Kozeta të paktën s'kishte prindër dhe prandaj vuante, — pëshpërita. Po ç'egërsira do të kenë qenë prindërit e saj, vallë?

Ah, jo, jo, prindërit e saj s'ishin egërsira dhe s'është faji i tyre në vuau Nurija e vogël! Ah! uria, uria gjakpirëse, armikja më e egër e më e pashpirt e shumicës së popullit, e motra e varfërisë, ajo e ka fajin. Varfëria, uria, vuajtja, pocaqia, sëmundja, i bënë prindërit e kësaj vajze të shurdhër e të verbër për të mos dëgjuar dhe për të mos parë vuajtjet e bijës së tyre, i çveshën nga ndjenjat njerëzore, aqë sa i bënë që ta mërgojnë edhe vajzën e tyre shtatëvjeçare për të marrë pak të holla; por me ato pak të holla të fituara nga shitja e lirisë së vajzës së tyre, e gjakut dhe e mishit të tyre kushedi sa halle mbuluan: urinë e familjes, sëmundjet e të vegjelvë dhe jetën e të gjithëve.

— Guxim e durim, o çupëzë e gjorë, se me punën tënde ti do të mbash familje, me gjithë që je e vogël!

— i thashë me zemrën të copëtuar dhe u largova.

... Sot mora vesh se Nurijen e vogël, ose më mirë trupin e saj, e çuan në shtëpinë e saj në katund. Vuajtja e parakohëshme e veniti Nurijen fatkeqe.

Mbanë një rruge, ku balta arrin gjer në gju të kalit, mbanë një rruge që dëgjon e heshtur ankimet e katundarëve që kalojnë, ndodhet varri i saj.

«STINA TË QETA»

Do të jetë një roman shoqëror e psikologjik sqenash të ndryshme të thurura si një stofë shumë ngjyrash që alternohen e ndahen e takohen duke kaluar në zgëqe të lloj-llojtë.

Do të nisi me një simfoni; 28 Nëntor me një nga heronjt më sympathikë, Lek Tashini. Do të jetë një shkollë patriotizmi. Do të mbarojë me një tjetër simfoni; 1 Maj dhe me një shumicë personazhesh. E para do të jetë pragu i dimrit, i luftëravet kundër elementeve të ashpër armiq; e dyta, pragu i verës plot shpresë për një jetë më të mirë, më të ngrohtë. Të parën e nis një personazh, një militant, në të dytën na dalin të bashkuar një sasi e madhe njerëzish të çdo dore në një vllazërim e barazi ideale; Ja simboli i këtyre dy simfonive.

Do të kalojë në shtresat e ndryshme të shoqërisë shqiptare; në atë që do të jetë e ardhëshmja, në atë që është e shkuara, në bejlerët e rënë, në pasanikët e rinj, në proletarët shekullorë, në të dyzet opinionet e Shqipërisë nga ai i hoxhës deri tek anarhisti. Tipare të jetës sonë në krahasim me jetën e vlllezërvet njerëz të tjerë; q'na bashkon e q'na ndan. Prekje e disa problemeve. Një e kapërxyer kinematografike nëpër sqena të ndryshme të këtij tertipi.

Duhet të shqitet nga e tëra e veprës një optimizëm e një besim i plotë për një t'arthme fatalisht më të mirë dhe një përpjekje e herojut «njeri» për t'iu afruar njeritjetrit.

Shënim: Kjo skemë tregon se K. Tutulani kish skicuar linjat e një romani, të cilën, siç duket, nuk arriti ta fillonte.

IV

SHËNIME MBI ARTIN E LETËRSINË

M I G J E N I

Gushti i parvjetshëm na rrëmbeu djaloshin, që ndofta do t'ish më i madhi poet i vendit tonë në këto kohë, «birin e shekullit të ri», Migjeni, uragani i vërtetë, fryti i neptë në shkretëtirën e «vullneteve të ndrydhura», të cilët i tundi me tèrbim (Oh, ç'zhurmë ferri lëshojnë zinxhirët, me habi e llahtar njeriu fillon t'i ndjejë të rënda) i zgjoi, si ushëtimë e fishkëllimës së tij jehuan «Këngët e ringjalljes»; pastaj u ngjit lart e lart atje ku përpinqen «shqiponjat me krahë të thyem» pér të nxjerrë me zë të fortë një blasfemi t'egër e të hidhur. Porsi «Shkëndi» e shkëputur nga zjarri i vatrës, e lehtë, u vërsul në liri duke trembur plakun e shkretë që me shkopin ngritur drejt qillit i thërriste, nga pragu i kassolles, rrebelit që la shtëpinë dhe pastaj ndriti, ndriti, ambël mbi «Lagjen e Varfér» ku «Melodi e këputur» përzuhej me «Balladën qytetëse» dhe një mijë «Kangë të pakëndueme», flenë në zemrën e ndonjë «lypsi të vogël». Se Migjeni ish poet aqë i «Dhimbës krenare» sa edhe i vjershës së përmallëshme që shkarravitet në fytyrën e zbetë të ndonjë gruaje të mjeruar.

Migjeni solli në truallin tonë një frysë të re poetike. Të re në çdo pikëpamje: motive të reja, shprehje të reja, horizonte të reja, melodi të reja. Sikurse çdo poet i lindur, ai nuk shkrojti vjersha, por këndoi këngën e tij, këngën pér bijët e njerkës në këtë botë, poezinë brutale të mjerimit, poezinë e revoltës kundër paragjykimeve — paçavra të mykura — poezinë e një agimi kuqërrrem që mis të shpërndaje me dritën e tijë

të errtit e një natë plot ëndra të liga. Sensibilitetin e tij delikat ua komunikon këndonjësve, të cilët i bën të rrojnë në lotin e gruas së varfër a në ethet e fëmijës së plakur para kohës. Pastaj me «gjakun kryengritës» të stërgjyshërvë të shtypur që i vlon ndër deje derdh gotën e helmit mbushur në trashëgim brezninash e shperthen një mallkim për «Idhuj pa krena». Me fuqinë e një Bau-delairi — i bie «pash me pash ferrit», të kësaj bote dhe ndjek jetën mizore nér kasolle ku bashkë me qej, mij, mica mbi pece të mykëta e të qelbëta lakuriqen mish-nat si zhangë, të verdhë e pisa... «Kënga e Migjenit shpërthen në Vargje të Lira, dhe kjo qe një lule e re me një erë të panjohur në kopshtin tonë letrar të më-suar me format e vjetra plot caqe e rregulla. Me qënë se ishte shpërthimi spontan i një shpirti të lirë, nuk mund të adoptonte muzikën monotone të një vargu të rregullt. Ndonëse, si kuptohet, nuk e krihte e nuk e përpunonte vargun e me gjithë se ndiesia muzikore e tij është diçka e veçantë që s'i përngjan melodisë melan-kolike e të butë të ndonjë poeti tjetër shqiptar, prap se prapë kushedi sa vargje na magjepsin me muzikalitetin e tyre.

Dhe sa vinte vargjet e tij përmirësoshezin, bë-heshin me të thellë, më magjikë, më «tërheqës»; poeti «I RI» fillonte të zotronte më e më mirë artin e tij.

Por, për fat të zi, jeta e Migjenit qe e shkurtër te-për. Ahere kur ata të pakët lëcités të vendit tonë, që ndjekin me interesim zhvillimin e jetës sonë letrare e artistike, filluan të shifnin tek ai një shpresë plot avenir, u venit në vetmi i varfër e i lënë në mëshirën e fatit. Dhe diçka më tepër; e shkurtër qe edhe zhurma që lindi rrëth tij. Dhe sikundër që nuk meritonte të vdiste aqë shpejt, ashtu nuk meritonte të harrohej aqë shpejt. Me rastin e vdekjes së tij të kobëshme u shkrua diçka në shtypin tonë; ose ndonjë nekrologji e thatë, ose ndonjë lëvdatë fjalamane; asnjë studim nuk u bë mbi të, asnjë kritikë me kuptimin e vërtetë të fjalës. Dhe e keqja më e madhe është se askush nuk u përkujdes që të mblidhen, në mos të gjitha, të paktën frutet me të

mira të pendës së tij. Është e vërtetë se kudo në këtë shekull «të motortë» ku zefiri i hollë dëndur bie erë benzinë, poetët janë fatkeqë dhe është me të vërtetë një heroizëm të ndjekësh me këmbëngulje të përpjetën e ashpër të Parnasit. Po Migjeni krijoi diçka që duhej ruajtur si visar. Me gjithë se nuk pati ndjekës e imitonjës sikurse Lasgushi, duhej, në mos t'influenco nga pakë poetët tanë të rinj me frymën e tij të ngrohtë, të zgjonte të paktën një tufë admiranjësish.

Nuk kam qitur cekën këtu të bëj fjalë mbi veprat e tij. Por dua vetëm, të kujtoj me rastin e dy vjetëvet të vdekjes së poetit, ata, të cilëve u vjen ndoresh më mirë se mua pér këto punë që Migjeni e vlen të mos harrohet, sa duhet të dalë ndonjë njeri që t'analizojë e të kritikojë veprën e tij e se duhet të përmblidhen e të shtypen në një libër vjershat e prozat e tija të botuara a të pabotuara.

*Botuar në parathënien e librit
«Veprat» të Migjenit.*

POEZIA POPULLORE — POETËT ANONIMË¹

Do të përpinqem të bëj shkurtimisht një tabllo të poezisë popullore shqiptare. Më mungon përgatitja e duhur, më mungon materiali, më mungojnë studimet përkatëse, sidomos nuk kam mundësi të ilustroj me leximin e përkthimeve të zgjedhura këtë referat modest. Megjithatë, me dëshirën që të bëj të njohur një rrëth miqsh, me atë që është një thesar i vërtetë për kombin tonë, do të bëj çmos, duke ju falenderuar që keni ardhur të më dëgjoni.

Poezia popullore, në një vënd si Shqipëria, ku poezia letrare ka qenë shumë e kufizuar gjer në kohët e fundit, zë një vënd të nderuar në thesarin shpirtëror. Kjo poezi anonime kalon gojë më gojë, brez pas brezi, duke interpretuar shpirtin e kombit tonë. «Kthehuنى te kengöt tuaja, نە دونى تە مەسونى historinە e vendit tuaj». Nuki e di kush e ka thënë këtë, por më duket e drejtë. Populli, kur nuk i japin këngë, i krijon vetë.

Poëtet tanë anonimë janë të gëzuar ose të trishtuar, sipas ngjarjeve që kendojnë. Mirëpo në vjershat e tyre pothuaj gjithmonë ndihet një drithtimë trishtimi; dhe me të vërtetëjeta në malësitë tona të ashpra është e vështirë, si ç'është e vështirë edhe historia jonë: «Një luftë epike kundër pushtuesish të panumërt për të mbrojtur vatrat tona». Prandaj ndihet edhe nostalgja e lirisë dhe një trishtim i fshehët burrëror. Që nga bëmat legjendare të Akilit gjer te epoka heroike e Skën-

1) — Origjinali italisht «LA POESIA POPOLARE — I POETI ANONIMI».

derbeut nuk ka veç luftëra e kryengritje të një populli që nuk di të shtrohet. Këta luftëtarë «flejnë më mirë me pushkën se me gruan» nuk kanë nxjerrë gjer në shekullin XVII pothuaj asnjë shkrimitar të madh. Po nga ana tjetër, nëqoftëse nuk ka patur ndonjë poet, eshtë një popull i tërë poetësh që ve në këngë bëmat dhe pasionet e veta. Sot Shqipëria eshtë vendi i fundmë i rapsodëve.

Do të hy drejt e në thelb të çështjes. Po më parë dua t'u kushtoj dy fjälë atyre që, të shtyrë nga dashuria për jetën mesjetare që ishte shumë e përhapur në shekullin e romantizmit, u ëdhënë pas mbledhjes së këngëve tona popullore.

I pari, Von Hahni botoi në Jena në vitin 1854 «Albanesische Studien», dhe një vit më vonë një mjek gjerman me emrin Rheinhold nxorri një antologji tjetër «Noctes Pelasgicae».

Pastaj në rradhët e folkloristëve radhitet Korçari Thimi Mitko që botoi në Egjypt (sepse atëhere në Shqipëri ish ndaluar botimi i librave shqip) «Bletën Shqiptare» në vitin 1877. Pastaj dollën të tjerë që zunë të zbulonin letërsinë tonë popullore. Këtu duhet përmendur vepra e çmuar e Gustav Meyerit. Edhe italo-shqiptarët kishin poetë, si de Rada, Camarda dhe Schiro që mblohdhën me dashuri të thellë margaritarë të vërtetë nga goja e popullit.

* * *

Heroi më i lashtë që takojmë në këngët tona eshtë Skënderbeu: mirépo poezia popullore eshtë shumë më e vjetër. Kështu kemi motive (pagane) që alternohen ose trazohen me ato të krishtere. Shumë figura përpunthen me ato të heronjve të Homerit dhe të legjendave bizantine, sidomos me Uliksin, Akilin, Circeen, Diogen Akritasim etj.

Duhet theksuar gjithashtu se shumë këngë popullore kanë variantet e tyre në kombet fqinjë; këtu nuk eshtë fjala as për përkthim, as për vjedhje, po për një

nënështresë të përbashkët: gjenia poetike popullore asi-milon frysëzimin e përbashkët, e përvetëson atë duke i dhënë vulën e mendimeve dhe të ndjenjave të veta.

Të fillojmë nga cikli i parë, d.m.th. nga ai që zhvi-llohet në të lavdishmin shekull të XV. Ai ruhet sidomos në kolonitë italo-shqiptare të Kalabrisë dhe të Siqelisë. Heroi qendror është Skënderbeu, trimëritë e të cilët përshkruhen në një mënyrë epike dhe në atmosferën e të mrekullishmes. Rreth tij regëtin një jetë heroike plot pasione dhe aventura.

Poeti anonim na tregon me fjalë të gjalla lindjen e Skënderbeut: «Gruaja kish parë në endë; perëndia i kish falë një fëmijë që ishte si drangua: trupi i tij mbulonte gjithë Shqipërinë, koka shtrihej gjer në Anadoll dhe kishte etje»; kështu endëronte Voisava. Princ Gjon Kastrioti, i shoqi, si malësor që është, di të kuuptojë endrat: «Fëmija do të bëhet luftëtar dhe tmeri i qenit turk». Dhe fëmija lind. Ai peng te turqit, bëhet Skënderbeu. Pastaj kthehet në atdhe, si të gjithë luftëtarët shqiptarë. Dhe poeti anonim këndon: «Qyteti mbarë rend t'i dalë para Skënderbeut dhe ushtrisë së tij. Një vashë mat hapin. Një djalosh ushtar i kap këmbën. Vasha lëshon një klithmë. E ëma thotë: Në është gjarpéri që e ka zënë, ka barëra që e sherojnë, në është dorë njeriu që e ka zenë ajo don që ajo dorë të jetë e burrit të saj». Pastaj e shohim heronë tonë më mes zotërve të Shqipërisë, si mbret të vërtetë, si i vetmi që, në të gjithë historinë, ditë ta kthente popullin tonë në një ushtri të disiplinuar, gjë që nuk kishin mundur ta bënin as romakët. Rapsodi kendon: Rrinin në tryezë Skënderbeu dhe Miloshini. «Miloshin, im vëlla, dil e shiko ç'bulima janë këto; në qoftë qelli që gjëmon, ktheu menjëherë; nëqoftë gjema e turkut, thirrmë. Ish pararoja turke me flamur të çpalosur. Miloshit i vjen turp të kthehet dhe pyet rininë e vet: o rini, sa zemra ke? — Nëntë zemra sa për nëntëqind! — O shpatë dashene, sa zemra ke? — Nëntë sa për nëntëqind!» Dhe kali i jep të njejtën përgjigje. «Bën kryqin dhe hidhet si sqifter mbi pullumbat e detit». Fitore të mrek-

kullueshme dhe të padëgjuara: Evropa e habitur brouhorit, vete Murati i II dhe pastaj Mehmeti, i biri, kërkijnë armëpushim. Skënderbeu zbatet në Itali për të ndihmuar Alfonsin e Aragonës dhe del ngadhnjimtar. Hidhet kundër venetikave që janë të vetmit aleatë të tij, po që duan të sillen si zotër, dhe i mund: dhe prapë nuk lë të marrë frymë armikun e Evropës: Shqipëria është mburoja e vetme e qytetërimit të krishterë. Dhe rapsodi këndon; Murati i çon fjalë luftëtarit: «Ti fiton se ke shpatë magjike, dërgomë shpatën dhe nuk do të fitosh më!» Dhe heroï i madh buzëqesh e dërgon shpatën. Mirëpo, me t'u ndezur beteja e parë, Murati ndahet edhe më keq. Atëhere cirret se Gjergji qenkish i pabesë: «Nuk më ke dërguar shpatën e vertetë!» — «Shiko se duhej të të kisha dërguar krahun, jo shpatën timë». Dhe shpata bie përsëri mbi turkun; 120.000 jenicerë shpartallohen, 80.000 të tjerë dhjetohen, dhe sultani, duke u grirë me vete, kthehet në Adrianopojë, për të vdekur nga turpi e nga dhembja. Ndërsa Evropa dridhet, ndërsa Konstantinopoja ka rënë në duart e turqve, ndërsa grekër, bullgarë dhe hungarezë bien nën këmbët e tyre, vetëm Skënderbeu qëndron në këmbë dhe vazhdon të ngadhnjeje: «Njeri apo perëndi është ky?» — pyet këngëtarë.

Këndoynë rapsodët, këndoynë poetët, këndoynë gratë dhe princërit luftëtarë, kur, ndonjëherë, heqin shpatat dhe kryqëzojnë... Një këngë e bukur është ajo e dasmës së Skënderbeut. Ky mbledh në Krujë të parët e vendit e peshkopet, për t'u këshilluar me'ta nga cili qytet të marrë gruan. «Zot; merre napolitane! — Dhe Skënderbeu përgjigjet: «Në Napoli gratë ngrihen vonë nga shtrati: qeverisja e vështirë e shtëpive tona i lodi dhe i frikëson! — «Ka në Pulje vasha...» — «Por janë mësuar në fushat e tyre të gjera dhe zemra e tyre do të ngushtohej në rrëthim e maleve tona».

«Merre në Siqeli, ku janë të bijat e mbretit...»

«Po këto, nga ai vend i nxeh të dhe nga flladi i detit, do të sëmureshin në thellimet e shkëmbinjve tanë... E dua shqiptare nga gjuha dhe nga zakonet.

Pastaj kenga e përmallëshme e vdekjes së tij; (fq. 43). Zija hyri në zemrat e shqiptarëve: xhoka tradicionale e Shqipërisë qëndrore nuk është më e bardhë, bëhet e zezë dhe e zezë do të mbetet edhe sot, pas pesë shekujsh. Poeti anonim këndon: «U derdh gjaku ynë... Nisi zoti Andre Turell tri gale: e para ish ngarkuar me vasha, e dyta me djelmosha, e treta me bukë. Kështu, fisnikëria shqiptare vjen e gjen mikpritje këtu, në Itali, ndërsa turku, tridhjetë vjet më vonë, do të zerë të gjithë vendin: «Malet» (faqe 44). Po atje ku luftëtarët lidhen me besa-besën tradicionale do të rilind gjithënjë e freskët shpresa e ringjalljes. (Kësaj bese) ky vend do t'i hartojë një ligjë, si ajo e Kanunit të Lekë Dukagjinit, një pasuri aqë e gjërë bukurish artistike, sentimentale dhe morale që do të rrojë edhe pas pesë shekuj sundimi aziatik. Të kalojmë tani në ciklin e dytë. Këtu nuk kemi më vjershën e lehtë tetërrokëshe po dhjetërrokëshin e rëndë skllav. Këto janë rapsoditë më të bukura të gjuhës sonë dhe ato lulëzojnë në malësitë e veriut. Gjeto Muji është heroi qendror, dhe personifikimi i burrit shqiptar. Bashkë me Mujin, Halili, i vëllai, veprojnë edhe tridhjetë agallarët e Jutbines, flasin kafshët e drurët, ndërhyjnë kriesat e mbinatyrëshme, si Zanat, Orët, Shtojzavallet, etj. Zanat shqiptare (të ngjashme me nimfat dhe muzat), kur mësojnë se sllavët kanë hedhur Danubin, dalin të kërkojnë heronë; dhe ky hero është Muji, një bari që, me ndihmën e orëve, bëhet i pathyeshëm. Ai sulet kundër sllavëve dhe i shpartallon gjithënjë. Është një luftëtar i ashpër dhe aventuresk, me një ndjenjë shumë të mprehtë të nderit; ai është gjallë edhe sot e kësaj dite, siç besojnë malësorët dhe siç këndojnë rapsodët festave: rri fshehur në një shpellë bashkë me Halilin dhe me të tridhjetë... pa njollë dhe pa frikë. Muji është trim, ndërsa Halili është dashnor i përgjëruar dhe..... agallarët e tjerë, si Gjergj Elez Alia janë personifikime (?) poetike të «Kanunit të Lekë Dukagjinit» «Besa, nderi, miku» etj. janë përbërësit e «burrnisë». Rapsodi përfshin ndjenja të një poeti vigan dhe nganjëherë është vështirë të bin-

demi se autori ka qenë një analfabet që nuk njihte as Homerin, as Danten. Më mungojnë, për fat të keq, përkthimet e këtyre rapsodive të bukura ose, të paktën, origjinalitet, që të bëj një përpjekje për t'i kthyer në prozë.

Tashti të vimë në ciklin e tretë: rapsodi dhe trubaduri bëhen kronistë që, fshat më fshat, me lahitën e malësisë, këndojnë trimërit e trimave; kështu, të kretnëteve shqiptarët dëgjojnë këngët epiko-lirike të Ali (pashë) Tepelenës, të Oso Kukës, të Bushatllinjve, të Himariotëve, të Suliotëve, këngë rrëth ngjarjeve historike, si Luftha e Krimës, kryengritja e Rexhep Shkodranit, e Mehmet Aliut, ato të luftës së petritëve si Zyluftar Poda, Çelo Picari, Gjon Leka, Çerçiz Topulli, Bellkameni dhe të tjerë. Këndojnë marjen e gjakut dhe ngjarjet më të rëndësishme. Ne elegji të mallëngjyeshme, po gjithënjë burrërore, vajtojnë vdekjen e personazheve historike.

Në këtë cikël mbretëron një thjeshtësi dhe shkurtësi kompozimi, pa hiperbolet e zakoneshme të ciklevë të para, pa shfrimet lirike. «*Le merveilleux*»¹⁾ rrон ende, po krijetat e mbinatyrëshme nuk ndërhyjnë më në fatet e njerëzve: vetëm zogjtë flasin dhe interpretojnë ndjenjat e personazheve, i ndihmojnë me shenjat e tyre. Elementi ekspositiv mbisundon plotësisht mbi atë lirkikëmi të bëjmë më shumë me shprehje sentimentale ekstatake.

Të tilla janë këngët që shoqërojnë jetën tonë shoqërore dhe popullin tonë nga djepi gjer në varr.

Këngët e djepit përbëhen nga vjersha të ëmbla të nënave, që u urojnë të gjitha të mirat foshnjeve; ato janë për t'u admiruar për figurat e bukura që dalin vetëveti nga shpirti i femrës shqiptare, dhe nuk ka shqiptarë që të mos e ketë zënë gjumi në atmosferën harmonioze të një ninulle.

Këngët e fëmijëve janë vjersha me harmoni imi-

1) E mrekullueshmja.

tative, shumë interesante për ata që merren me psiko-logjinë e fëmijës.

Këngët e dashurisë janë vjersha shumë të bukura që, me thjeshtësinë e tyre, shprehin me forcë sugjpressive... e ditëve të kremte, si edhe ato që shoqërojnë ceremonitë e martesës, ceremoni fort interesante nga shumë pikë-pamje. Si kalon rinia, njeriu gjen kënaqësi të kritikojë... nepërmjet humorit, institucionet dhe zakonet; *castigat ridendo mores*; kështu lindin këngët humoristike; një këngë jep dhe lamtumirën e fundit, dhe, rrëth të vdeku-rit, gratë këndojnë dhe improvizojnë vjersha që shprehin dhembjen dhe tregojnë cilësitë e të ndjerit. Vaji i nënës malësore është i singertë, dhe nuk është arti që e bën të shfrejë në figura të mrekullueshme, por fakti se malësorja jonë është, në mënyrë të pavetëdijëshme, po agë poetesh, sa edhe rapsodi.

Shqipëria është e ndryshme në krahinat e saj: mentaliteti i malësorit ndryshon shumë nga ai i qytetarit, kështu, edhe poezia popullore që pasqyron karakterin e vendlindjes nuk mund të mos ndryshojë nga një vend në tjetrin. Megjithatë, këngët tona popullore kanë gjithënjë diçka të përbashkët; kjo është aspirata e vazhdueshme për diçka më të bukur, për një jetë më të lirë dhe më të pavarur. Populli shqiptar nuk është i lehtë për t'u kuptuar: por, po arrite t'i hysh në zemër, do të zbulosh një pasuri të madhe shpirtërore. Një popull që trashëgon brez pas brezi një letërsi popullore kaq të pasur, një dashuri të pamatur për liri dhe për virtute, të tillë si kulti i nderit, mikpritja dhe fjala e dhënë, nuk mund të jetë kurrë i fundmi i... sic thotë Kinigo. Pikkërisht fjalës së dhënë, të cilën nuk mund ta shkelë as vdekja, i këndohet në këngën e Garentinës ose të Dhorruatinës që do të lexojë shoku Lorenconi. Kjo këngë ka tri variante: dy në Shqipëri dhe një tjetër, më të lartë, në kolonitë shqiptare të Italisë. Përkthimi i tanishëm është marrë nga ky i fundit.

ARTIKUJ, BISEDA, FJALIME, LETRA

MAJI I LULEVE, I GJAKUT E I SOLIDARITETIT PROLETARIAN

(Ligjeratë përkujtimi)

Një Maji është ditë lulesh, dita e zgjimit të natyrës. Ka qenë kurdoherë një ditë shprese. Kurdoherë ka ngjalur në kraharorët e njerëzve shije jetë e lirije.

Më 1889 në Paris mblidhej një kongres punëtor, nga ata që dëndur shifeshin pas predikimit revolucionar të Karl Marksit. Shfaqet mendimi i caktimit të një dite punëtore ndërkombe të, në të cilën proletariati i shtypur prej shekujsh të rrëfente me zë të math se kërkonte pjesën e tij ndénë diell e të përtérihej në vëllazërimin e një bote të re që është për t'u realizuar. Ky mendim të gjithëve u pëlqeu. Po cila ditë duhej caktuar si e krejtja e luftës dhe e solidaritetit të proletariatit të botës? — Katërmbydhjet korriku — propozoi një pjesë e madhe e kongresistëve, sepse marrja e Bastilles një shekull më parë shenon fillimin e shkëputjeve të prangavet. Të tjerë propozojnë të tjera data që përkujtojnë të tjera episode nga lufta e gjatë e popullit për liri.

Në mes të këtij bisedimi, ngrihen e flasin përfaqësonjësit e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Ata janë serjozë dhe thua jse të përzishëm bëjnë një kontrast të gjallë me fytyrat e të tjerëve, në të cilat shfaqet çiltazi entuziasmi i ngrohtë. Pernjëherësh kjo zymtësi përhapet në të gjithë të mbledhurit. Amerikanët propozojnë 1 Majin dhe salla ranon me anën e një heshtjeje të thellë.

Përse vallë? Ç'kish ngjarë me 1 maj? T'ishte se ky përhapej nga shkaku i poezisë së vjetër t'asaj dite, apo nga symboli i rilindjes se jetës që përbledh 1 maji, fytyrat e kongresistëvet do t'ishin bërë më të çelura. Jo, nuk i shtytën të gjitha mendimet ata luftëtarë t'ash-për, se ndryshe përse kjo heshtje e thellë si përparran një arkivoli?

Punëtorëvet luftëtarë n'atë çast u binte ndër ment dita e majit 1886, tre vjet më parë, në Chicago t'Amrikës, dita e gjakut puntor që u derdh pa kursim nepër rrugët e atij qyteti të madh nënë pallatet madhështore të të cilët rënkuau proletarët vllezër.

Në nëntor e dhjetor të 1885 bota e mahnitur pa n'Amerikë një lëvizje të dendur në kampin e puntorisë: vendosi që «çështja e tetë orëve» t'i imponohesh botës industriale. Dhe për të vënë në zbatim këtë vendim, punatoria do të përdorte armët e saj, që tani së fundi ish rrëfyer e fortë: «grevën». Dhe nisën preqatitjet përnjë lëvizje me proporcione me të vërtetë kolosale. Për të pasur kohë pér t'iu preqatitur mirë punës, data e nisjes së kësaj beteje gjigandeske u la pér disa muaj më vonë, në 1 maj të vitit tjetër, d.m.th. 1886. Dhe me të vërtetë më 1 maj 1886 mijëra e mijëra punëtorë braktisën punën në shenjë proteste. Më se 200.000 punëtorë arriten në fitore, padronët e trëmbur nga kjo fuqi e tmerrëshme që vihej kundër kapitalit, pranuan, u mundën.

Por Çikagoja do të lahej me gjak, e lypte pangopësia e disa kapitalistëve, se ndodheshin në këtë qytet, në mes të padronëve, disa që nuk pranonin me asnje kusht ta çlironin pakës hallkën që po të mbyt, punëtor, o vëlla! Ahere qolliti ngjarja e zezë: ushtarë, bij proletarësh, të detyruar të bëhen vegla kapitalistësh, u ranë vëllezërve të tyre dhe ata, që s'ngopen dot me djer-sën e lotin e popullit, u ngopën me gjak.

Ky qe Maji i kuq i Çikagos; tre vjet më vonë u pranua prej kongresit ndërkombëtar të punëtorisë si një ditë lufte e solidariteti të proletariatit.

Cdo vit të tjerë punëtorë bien fli, të tjerë qytete

shohin Majin e kuq, të tjerë kapitalistëve u bie maska e u del në shesh ftyra e ndyrë. Por çdo vit maji proletar, maji i solidaritetit e i protestës bëhet gjithënë më shumë maji i shpresës.

Se nga kjo tokë prej shekujsh e vadirur me gjak e lot e djersë diçka po çel një lule e re, përjetërisht e re si lulja e Fourmysë¹⁾ mbi shpatullat kurdoherë më të forta të ushtrisë punëtore, përhap rrezet një diell i ri që po agon. Dhe punëtoria kuption se me majin e luleve dhe të gjakut natyra po zgjohet në një atmosferë të re, të vakët. Me majin e solidaritetit jemi në prag të një vere plot të mira.

1 maj 1941

Botuar në gazeten «ZËRI I POPULLIT» 5 maj 1963

1) Në Fourmy një vajzë e re me një lule maji në dorë, në manifestimet e 1 Majit, i nxiti shokët e saj proletarë në një protestë të zjarrtë. Plumbi i parë goditi mu në zemër vajzën trime dhe lulja që ajo, në at çast shtërgonte në gji, u skuq me gjak, u përjetësua në legjendat populllore.

Ç'ËSHTË MBLEDHJA EDUKATIVE?

Ç'është mbledhja edukative? Pse jemi mbledhur këtu?

Mbledhja edukative është një shkollë në gji të grupit aktiv. Përmbleth djem të ndërgjegjshëm që nuk duan të humbasin në korruption e duan të përmbushin misjonin e tyre si njerëz. Ka për qëllim të krijojë revolucionarë të vetëdijshëm dhe aktivë marksistë.

Është kujtuar se fashizmi e ka lënë rininë pasdore. *Fashizmi don që rinija të jetë injorante e prandaj e vë në gjumë. Don që rinia të jetë e pafuqishme kundrejt tij e prandaj e hedh në korruption. Don që rinia të mashtrohet e të mos jetë në mbrojtje t'interesavet të vërteta popullore e prandaj i fsheh çdo të vërtetë mbi komunizmin.* Prandaj rinia grumbullohet në grupe edukative që të mos vihet në gjumë, që të mos korruptohet; kështu që fashizmi shtypës të mos i hedhi dot hi syvet.

Edukatori të tregojë methodhat me të cilat fashizmi përkrah injorancën: shkollat fashiste dhe kufizimi i diturivet, mungesa e shtypit të lirë, edukimi i bindjes së verbër, etj. Të tregojë pse fashizmi e dron fuqinë e rinisë (se çdo fjalë e tij është mashtrim dhe duke u paraqitur si një regjim i popullit, revolucionar, anti-imperialist, nuk është veçse një regjim i shtypjes së popullit proletar nga një oligarqi, sikurse çdo formë shteti për deri sa është kapitalizmi) dhe në ç'menyrë e ko-

rrupton dopolavoro e organizatat e tjera, favorizimi i nxitjes s'instinktit t'urrejtjes, përçarja e vëllazërimit të djalërisë botnore. Të tregojë se si fashizmi paraqitet si përkrahës i masavet popullore (kurse ai në të vërtetë forcon eksploatimin kapitalist duke shkatëruar organizatat punëtore dhe ndërsa paraqitet si antikapitalist, u heq nga duart punëtorëvet çdo mjet për të luftuar kapitalizmin, se gjoja do ta luftojë vetëm ai vetë n'emër të popullit) se si kërkon të ndalojë çdo vepër të masës vetë kundër shtypjes kapitaliste (greva etj.) e sidomos se si fashizmi ka krijuar një mijë përralla kundër «rrezikut komunist» për të luftuar «rrezikun komunist», kurse partia Komuniste është mbrojtësja më e rreptë e interesavet të masavet popullore dhe nuk formon rrezik veçse për fashizmin dhe kapitalizmin që fshihet prapa tij.

Prandaj të rinjt që nuk janë mashtruar nga fashizmi, formë e rafinuar e shtetit shtypës, mblidhen në këtë shkollë të rinjsh. Kështu forcohet morali dhe gjyki me theorinë marksiste e mbruhën revolucionarë të vetëdijshëm. Shkolla është e lirë. Para mbledhjes caktohet (propozohet e pranohet) një program ekonomik-historik-politik rrëth theorive Marx-Leniniane rrëth zhvillimit ekonomik dhe historisë sociale, rrëth partisë dhe Bashkimit Sovjetik, rrëth luftës së klasave dhe shtetit, rrëth problemesh në lidhje me realizimin e shoqërisë socialiste o me jetën në një shoqëri socialiste pa klasa. Edukatori që do të bashkëpunojë me anëtarët e grupit, duhet të mbaj mënyrën e të folurit që i përshtatet gjendjes së të rinjve, t'u fitojë zemrën, të jetë modest e jo pedant, të zgjojë kureshtjen e të harmonizojë zhvillimin e mendimevet të ndryshme me llogjikën e qartë e t'i sjelli në konceptin marksist tendencat e ndryshme ende të papjekura. Edukatori duhet të jetë shëmbëll morali për të rinjt. Nga ana tjetër sa herë që të mos jetë i sigurtë përpara një theme të mos nxitohet të japi përgjegje pas kokës së vet, por ta lërë për në mbledhjen tjetër, të kërkojë ndërkohë zgjidhjen e pro-

blemit në mënyrën marksiste duke shqyrtuar tekstet e duke u këshilluar me kolegët në mbledhjen e edukatorëvet. S'ka gjë më të rrezikëshme se sa t'u japësh të rinjvet njoftime të gabuara; do t'ishte tradhëti. Do t'ish-te e dëmshme gjithashtu t'u jepen të rinjvet lëndë që ata nuk i tresin dot; duhet të përdorim gjuhën e tyre e t'i përtypim mirë lëndët për t'ua lehtësuar tretjen.

Sot Partia Komuniste është ilegale; pra edhe grupi edukativ i të rinjvet komunista është i fshehtë; prandaj vetveti është një zgjedhje djemsh të guximshëm. Sot Partia Komuniste është në një veprimitari të gjallë; pra edhe grupi edukativ përbëhet nga djem punëtorë. Pra sot parashihet që grupi edukativ të përbledhi djemtë që kanë elementet më të nevojshme për t'u bërë revolucionarë të mirë. Në këtë periudhë kur edukata dhe kultura shkojnë krahas me pervojen e fituar në luftën e hapët të Partisë, shpresohet të dalin anëtarët e vlefshëm të partisë, ajka e proletariatit për rindërtimin e nesërm socialist. Pra, ata që marrin pjesë në grupin edukativ, le të jenë të vetëdijshëm të misionit që proletariati dhe shoqëria u ngarkon. Duhet të bëhen aktivë, të vetëdijshëm të detyravet të tyre, që duhet t'i përbushin me vëtmohim dhe guxim. Duhet të kenë të gjitha ato elemente të vlefshme për një komunist, ato që janë cilësitë themelore të anëtarit të Partisë.

Grupi edukativ kërkon të përgatisi anëtarë të vlefshëm partie për udhëheqjen e revolucionit proletar dhe të ndërtimit socialist dhe aspirata m'e madhe për çdo anëtar të grupeve është të jetë anëtar i Partisë Komuniste dhe udhëheqës i proletariatit në rrugën e shpëtimit. Është e vërtetë që edhe duke qënë vetëm një aktivist, i riu vepron me sa mundet në të mirë të çështjes komuniste e dëndur ka mundësi të veprojë edhe më tepër se një anëtar, se ndofta duke qënë i ri ka mundësi të hyjë në masat e reja atje ku dalin më të guximshmit e më të sakrificës. Hidhet në aksione të forcës dhe lufton me guxmin që i fal rinia dhe shpirti i tij i kulluar, me po atë guxim që lufton dëndur edhe një revolucionar i pjekur si duhet të jetë anëtar i Partisë. Por nga mosha e tij e re, nuk është akoma në gjendje

të udhëheqi turmën proletare; dhe me qënë se i mungon ende ajo pakicë kulture marksiste e nevojshme për një komunist të vetëdijshëm, ende nuk është dalluar si eliti nga masa proletare përgjithësisht (simpatizohet). Gjë që do t'arrihet duke fituar, me përvojën e aktivitetit, pjekurinë revolucionare e si të kenë marrë kulturën e nevojshme për të qënë të vetëdijshëm e të qartë në zbatimin e direktivave e të vendimeve të celulës. Prandaj qëllimi grupi aktiv-edukativ i rinisë ka për qëllim t'i japi Partisë Komuniste në periudhat luftëtare të revolucionit dhe të ndërtimit socialist anëtarë të vlefshëm aktivë e të vetëdijshëm, guximtarë e të sakrificës.

Këta të rinj do të fitojnë preqatitjen dhe vendosmérinë. I përgatitur quhet ai që ka fituar pjekurinë revolucionare (në teori e praktikë). I vendosur është ai që jetën e vet e konsideron si një mision. Kështu do të janë të vlefshëm për kështjen komuniste; ambicja më e madhe e tyre do të jetë: të janë sa më të vlefshëm. Do ta tresin aktivitetin e tyre n'atë të shoqevet e shokëvet të tjerë në një vllazërim të plotë shpirtëror si i ka hijë një komunisti. Këtu qëndron rëndësia e madhe e grupit aktiv edukativ.

Shumë herë i riu, në konditat e soçme të shoqërisë gjen pengesa për arritjen e këtij qëllimi. Të tilla pengesa na i venë ata që na shtypin dhe mjeti që përdorin për të ndaluar aktivitetin dhe preqatitjen tonë, është policia. Duhet të mësojmë se si të ruhemë prej saj, se si t'u shmangem provokacionevet të saj e si të mos nxito hemi që të mos biem pa pandehur në rjetat e saj, se si të sillemi në rast se jemi në kthetrat e saj. Duhet të bisedojmë midis nesh në mbledhjet edukative. Shpesh herë pengesat vijnë nga prindët a eprorët e rinisë. Duhet të dijmë të sillemi me ta, t'u fitojmë besimin e të bëjmë ç'mos për t'i bindur mbi vërtetësinë e çështjes sonë dhe mbi nevojën e aktivitetit tonë. Biseda rrëth sjelljet tonë mbi çdo rast të veçantë le të bëhen në mbledhjet edukative. Pengesa të tjera na vë shoqëria përgjithësisht më paragjykimet e saj; këtyre paragjykimevet, gjenjeshtravet konvencionale të shoqërisë borgjeze do t'u japim një luftë pa mëshirë, sa herë që ta kërkojë puna, me fjalën dhe me sjelljen tonë.

Pengesat më të mëdha janë mbeturinat borgjeze tonat. Me autokritikë e kritikë, me moralin e pastër të komunistit dhe me vullnetin e revolucionarit do t'i zhdukim këto mbeturina. Të përpikët në mbledhje e në përmbushjen e detyrës, me moral e cilësira të revolucionarit komunist, këto pengesa që rrjedhin nga ne do të zhduken si retë e zeza kur zë e frysni veriu i prillit dhe afrohet 1 Maji i punëtorisë.

— PARTIJA KOMUNISTE —

Aspirata më e madhe e çdo amëtarë të një grupei aktiv-edukativ është të hyjë në rradhët e Partisë Komuniste, të marri emërin partizan në luftën e saj. S'ka ndër më të math për njerinë (për atë që është i denjë për emrin njeri) se të jetë anëtar i Partisë Komuniste. Por nuk është fort e kollajtë të hysh në Partinë Komuniste; është shumë e kollajtë të dalësh.

Ky është një bashkëbisedim me propagandistët e rinisë në Berat në kohën e luftës kur Kristaq Tutulani ishte Shefi i Agitpropit të Partisë të qarkut të Beratit.

GRUAJA NË T'ARDHËSHMEN

a) Gratë do të hyjnë në produksjon e n'aparatin shtetnor dhe do të shkëpusin prangat e jetës patriarkale: hyrja e gruas në jetë është një evolucion i natyrëshëm.

b) Eksperiencia na tregon se në shoqërinë e soçme, kështu si është shpirtërisht e materjalisht, gruaja punëtore vuan; mizerje, shkatërrim i vatrës — keqësim i maternitetit e i rritjes së mirë të fëmijës.

c) Është pra e domosdoshme që shoqëria të verë mbi tryezë edhe problemin e zhvillimit të gruas në t'ardhëshmen. Dalin në shesh tri fate kryesore të këtij problemi:

1/ Barazimi dhe emancipimi i gruas jo vetëm përpara ligjit të shkruar, por edhe përpëra atij ligji të fortë që i thonë traditë a zakon.

2/ Vendosja e problemit të seksevet e sidomos të martesës e të jetës familjare mbi baza të reja më të shëndoshë.

3/ Përkujdesja e shoqërisë dhe e shtetit për rritjen e mirë të fëmijës.

VDEKJE FASHIZMIT — LIRI POPULLIT!

(Skemë trakti)

Vetëm tek armët tona qëndron sigurimi i një të nesërme të bardhë: Pamvarësia e Kombit shqiptar, demokracia popullore, paqja e begatia. Ftojmë popullin shqiptar të mos bjerë në grackën e mashtimit t'armikut. Çdo konçesion që armiku shtrëngohet të na japi është një pemë e helmuar: ajo pemë mund të duket e ëmbël se na kënaq një pjesë të vogël të dëshiravet tona kombëtare, se na kursen ndonjë sakrificë që do të pësonim, por në fund do të jetë e hidhur, se mban helmin e përçarjes në fe, klasa, krahina e rrryma politike, se kërkon të na përgjumi për një çast të vogël, që të na gjejë pastaj të dobësuar e të na shpartallojë keq, të na shtypi e të na bëjë mish për top për interesat e armikut fashist. Populli shqiptar këtyre marifetevet të armikut duhet t'u përgjigjet në mënyrë të prerë: asnjë kompromis, asnjë ujdi me armikun e fëlliur, se çdo ujdi është kundër interesave të jetës sonë kombëtare, na sjell skullavëri, luftë për të tjerë, djersë për të ndërtuar burgun tonë. Përpjekjet që bën fashizmi italo-gjerman për të shtyrë në dorë një paqe të veçantë me njerin nga aleatët, popujt sovjetikë e anglo-amerikanë u janë përgjegjur me një zë: luftë gjer në dorëzimin pa kushte t'armikut. Fashizmi, për t'i shpëtuar kangrenës së frontit të mbrëndshëm europian, bën gjithashtu përpjekje të përcajë e të thyejë luftarët e lirisë duke i vënë të vriten e të grinden njeri me tjetrin, popull me popull, klasë me klasë, krahinë me krahinë, rrymë po-

litike me rrymë politike, ose t'i gënjejë këta luftëtarë me sheqerkat e hidhura të koncesionevet e t'u marrë armët. Edhe ne të gjithë popujt e shtypur këtyre përpjekjeve le t'u përgjigjemi me një luftë të përbashkët e të pandarë gjer në dorëzimin pa kushte t'armikut. Lufta e shqiptarëvet na siguroi indipendencën me gojën e Cordell Hull-it, Mollotovit dhe Edenit dhe kjo luftë do të na sjelli ditën e bardhë të lirisë.

D A R V I N I

Një ballë i gjërë, dy sy të thellë, një mjekër e bardhë dhe e dëndur, ishte e pamundur të mos ndjeje përpara tij respektin që meritonte. I thjeshtë në madhërinë e tij, si njeri, ishte një zëmër plot mirësi e fisnikëri; si shkencëtar, ishte një mëndje e paisur me një vështrim të gjithëmbarëshëm; kaloi një jetë pune të palodhur e të regullt ndërmjet fosilevet e bimëvet, ndërmjet kupës madhështore të qiellit e botëvet misterioze që hapeshin ndënë mikroskop. Ky ishte i madhi Karl Darwin i doktrinës evolucioniste, së cilës i dha shpirt, e ilustroi dhe na e paraqiti me fjalë të thjeshta (e jo në terminologjinë e rëndë e të koklavitur të fillozofisë, por në faktet e dukëshme të shkencës) si një at i mirë që merr për dore të bijt e mitur e u shpjegon plot gjëra të kësaj bote. Karl Darvini është një hero si i mendojmë ne heronjtë modernë.

Leu në Shrewshyri më 1809 në një shtëpi të qetë që rrëthohesh prej poezisë së një natyre plot gjallëri e që rruante në rrafset e libravet kaqë kujtime shkençë e diturie. Në këtë çerdhe të qetë dashuroi natyrën e shkencës në mënyrë më të paqtë, më të ngrohtë, më të sinqertë, që mund të bëhet; aty nisi të ngrejë në trutë e veta planin e veprës së madhe. I ati desh t'a bënte prift, por nuk qe e thënë që botës t'i humbiste ky gjeni, se Darvini e la theollogjinë e nisi udhëtimet e tija rrotull botës si natyralist për të mbledhur elementet e duhura për veprën e tij. Pastaj u tërhoq në një ishat të Kentit e kaloi jetën në paqën e ngrohtë t'ambjentit dhe të dashurisë së sinqertë të së shoqes. Punon-

te ngadalë, por në punë të ngulur. Rrahu fusha të gjëra diturie; nuk qe vetëm një zoolog, një botanik, një gjeolog; në mendjen e tij mori gjallëri një «ide e madhe» që bashkon e pasqyron punën e materies organike në gjenëzën e zhvillimin e saj, jetën në tërë manifestimet e saj e udhët që ajo ndjek. Kjo ide del shpesh në librin e tij «Mbi origjinën e llojeve» si edhe n'atë që e ndjek: «Mbi origjinën e njeriut».

Nga vërejtja e drejtpërdrejtë e faktave zoologjike ai njoju e përqafoi idenë e një origjine të përbashkët ndërmjet llojevet të kafshëve e të bimëve në krye të kohës; ishin të pakët ata që guxonin të shprehnin atëhere ide të tilla, ndërsa shkenca zyrtare dhe akademike pranonte principin: «Aqë janë llojet e kafshëve, sa i krijoi Enti Suprem» (To errumeramus species quot aravit supremus sens).

Para Darvinit francezi Lamark kishte pohuar se kemi një njësi të mbretërisë së gjallësavet, se të gjitha gjallësat ndryshojnë ngadalë, gradualisht, ndënë influencën e agjentavet të jashtëm (ambjentit në të cilin rröjnë, ushqimit që marrin, etj.) se karakteret e tyre pastaj kalojnë për trashëgim. Darvini bëri një hypotezë të re mbi arësyen e ndryshimit të ngadaltë të llojevet të kafshëvet: seleksionin. Duke studiuar bashkimin e kafshëvet shtëpijake ai vu re se blegtori ndërzen dy kafshë që paraqisin një karakter të veçantë që i intereson atij; dhe piella për trashëgim atë veçanësi e paraqet në mënyrë më të dukëshme; kështu, prej një gjeneratë në një tjetër kjo veçanësi vihet aqë në duke sa që lloji i ri, pas shumë shekujsh, ndryshon krejt prej gjyshërve, nga të cilët rrjeth (përveç ndonjë përashtimi); ndonjë rrasti sporadik që për atavizëm paraqet trajta të qëmoçme). Kështu na del në shesh një lloji ri për arësyen seleksionimi, d.m.th. zgjedhjeje.

Tani vjen pyetja: përsë kafsha, që zgjodhi blegtori, paraqiste atë karakter të veçantë? Në këtë pikë Darvini s'është i një mëndjeje me Lamarekun: Kjo veçanësi nuk ka rrjedhur nga ambjenti, se po t'ishte kështu do të dukesh edhe në kafshët e tjera që janë rritur bashkë me të në të njëjtat kondita. Shkaku nuk është

pra i jashtëm (konditat e jetës) por i brëndëshëm, në dinamizmin e jetës vetë, në strukturën e tesutit e të qelizës, në protoplazmën e në kimizimin e saj.

Dhe si ndahet kësisoj nga Lamarku, shkon më tej. Pas Darvinit të gjitha llojet e kafshëvet rrjedhin nga seleksioni i tipave, të cilat bashkohen pér riprodhim. Por në kohët e egra, kur vepra e njeriut s'ishte, cili e bënte këtë zgjedhje? Kur seleksioni s'ishte artificial si bëhej seleksioni natural? Këtu Darvini e zgjith problemin me anë të luftës pér jetesë; gjallesa paraqet më pekul një karakter të veçantë të vlefshëm pér luftën e jetës, nuk thyhet kollaj në këtë luftë, përhapet më fort e prej gjenerate në gjeneratë e përforcon karakterin e saj të veçantë: Kështu dalngadalë dalin lloje të reja kafshësh e bimësh e zhduken llojet e qëmotëshme. Me nga dalësinë e vet seleksioni që është rezultat i luftës pér jetesë nxjerr në shesh efekte gjigande.

Gjeologjija e paleontologjia i dhanë dorën theorisë s'evolucjonit të formavet të jetës. Dheu i ynë mban në gjirin e tij si në raftet e një muzeu, fosile kafshësh të vjetra të vendosura në shtrate tokash që janë të periu-dhavet të ndryshme e që janë provën e ndryshimit të ngadaltë të formave. Sot s'ka kush dyshon mbi kalimin prej një lloji në një lloj tjeter, askush s'mund të thotë se këto lloje kafshësh e bimësh, që shohim ne sot, kanë qénë që në krye të kohës, nuk kanë ndryshuar e as nuk do të ndryshojnë.

Pra Darwinizmi na paraqet një fakt të pamohuarshëm: evolucjonin e ngadaltë të formavet, në të cilat manifestohen fenomenet e jetës. Si shpjegim të këtij fakti ai vë hypothezën e madhe të seleksionit artificial (që rrjedh nga vepra e njeriut në kafshët shtëpijake) ose natyrale (që rrjedh nga lufta pér jetesë në të gjitha gjallësat).

Ndërsa faktin nuk mund t'a rrëzojë njeriu, këtë hypothezë shumë kush e ka vënë në dyshim. Kështu të shumtë janë ata që vunë re se seleksioni nuk është i mjaftueshëm e se zgjedhja natyrale ndryshon kryekëput nga ajo artificiale (vepër e njeriut). Nga ajo e Darvinit lindi ideja e seleksionit natural). Të gjithë këtyre u

jejet përgjigje se rastet që ata vëmë në dukje janë raste të veçanta e jo të përgjithëshme. Shumë kush e luftoi Darwinin se nuk e kuptoi mirë atë që plaku i reverueshëm donte të thoshtë në shprehjen luftë për jetesë. Darvini këtë nuk e kupton ngushtë vetëm si një luftë në të cilën luftëtarët që marrin pjesë në të janë gjithënë koshjentë: ky është ligji fatal i kauzalitetit, i cili e sajon dhe e përbën këtë luftë; as që e kupton Darvini këtë për një luftë gjithënë me thonjë e me dhëmbë, por edhe si forma të ndryshme luftimi të padukshëm.

Pra si shpjegim i evolucionit të llojevet seleksioni qëndron hypothezë m'e fuqishme. Me gjithë atë mund të themi fare bukur se të gjitha hypothezat nuk janë, dhe ato, për t'u hedhur poshtë. Pra mund të themi: në disa raste shkaku i evolucionit janë rrethanat e jashtëme (ambjenti), në disa të tjera arësyet e ndryshme që kanë sjellë prishje në zhvillimin embrional, në të tjera hypotheza të ndryshme që kanë hedhur shkencëtarë të ndryshëm, por në më të shumtën e rastevet shkaku i ndryshimit të llojevet gjatë kohës është seleksioni natyral (artificial, në kafshët shtëpijake). Për të mos harruar është se ka edhe raste ku një lloj kafshësh e bimësh ndron për një herësh: janë përgjithësisht raste të jashtëzakonshëm. Darvinit pa dyshim i kanë shkuar ndër mënd këto raste, ndonëse nuk bën fjalë në veprat e tij. Këtu le të themi se edhe kjo mënyrë ndryshimi të llojeve zhvillohet ndënë kontrollin e seleksjonit natural.

Përveç gjithë këtyre rrëth evolucionit të llojeve bota Darvinit i detyron shumë të tjera: në veprat e tija të shumta anglezi i math na ka dhënë shpjegime e zbulime të panumurta në botanikë, anatomi, fiziologji, biologji. Veç asaj me vepra të pasardhësvet të tij theoria e evolucionit kapërxeu gardhin e shkencavet naturale. Del më pas Spenseri, e përqafon në filosofinë e tij konceptin e evolucionit. Përjetësohet me anën e Darwinizmit principi i kazualitetit për të cilin çdo fenomen është rezultat i një shkaku e njëkohësisht bëhet shkak i një rezultati të ri. E hendeku që hapi ai vijon të hapet edhe sot 60 vjet pas vdekjes së tij.

* * *

Ndërmjet vepravet të shumta të Darvinit përmëndet edhe ajo mbi origjinën e njeriut, i cili si kafshë që jeton në këtë botë duhet t'i bindet edhe ai ligjit t'evolucionit. Kështu organet rudimentare të njeriut nuk shpjegohen ndryshe, veçse si mbeturina pjesësh që njeriut të sotshëm i mungojnë, që i hasim në kafshë të tjera. Një krahasim midis fuqisë mendore instinktive dhe cilësive të tjera të njeriut dhe atyre të majmunëvet antropomorfë na jep përfundime të çuditëshme. Kështu Darvini përfundon se edhe njeriu, gjatë shekujvet, ka bërë dhe vijon të bëjë si çdo gjallesë evolucionin e vet për seleksionimin natural. Ishte e guximëshme kjo ide e Darwinit, mbasi deri atëherë ish besuar që njeriu, si mbret i gjithësisë, të mos ishte një lloj me kafshët e tjera. Si, pra, njeriu paska një origjinë të errët të përbashkët me kafshë të tjera (së afërmi me majmunët e së largu me mamiferët e tjerë) e si pra lloji i njeriut ndryshoka gjatë shekujvet e do të vijojë të ndryshojë përtë dhënë, me kalimin e shekujve më vonë, ndonjë lloj nga njeriu i sotshëm? Si bëhet që forma e sotëshme e njeriut, struktura e tij fiziologjike e fenomeni spiqik nuk qënkeshin veçse rezultat i konditave fizike e kimike të planetit e që për një përfundim pakëz të ndryshëm të seleksionit këto struktura e fenomene mund t'ishin krejt të ndryshme nga c'janë? Një grusht të fortë i dha ky pohim i Darvinit kryelartësisë së marrë të njeriut, i cili ka dashur të ketë në pekul një origjinë të veçantë jo të ngjashëme me atë të kafshëve të tjera (shif Biblën), të jetë krijuar kastile, ndërsa çdo gjë rrëth tij të jetë krijuar përtë. Por ky koncept antropocentrik ish pa kuptim, se njeriu dinjitetin e vet nuk duhet t'a justifikojë me një origjinë të veçantë, por tamam me faktin që ka dalë nga një shtrat me kafshë të tjera, mori guximin të mos qëndronte më te shpellat ku banonte e ka pasur fuqinë e monstravet që e rrëthonin të pushtonte botën me fuqin e gjykit të tij; njeriu qëndron një kafshë e si e tillë do të bëjë evolucionin fatal e tamam në kë-

të evolucjon shënon përparimin e rafinimin e formave me të cilat manifestohet fenomeni i jetës, shikon triumfin e tesutit nervoz të trurit mbi karrocat e eshtrat e kafshëve parahistorike. Le të bëjë njeriu pra evolucionin e vet e le të qëndrojë pararojë e zhvillimit të gjallnesavet: le ta jap përfundimin e vet seleksioni natyral në këtë luftë pér jetesë, që do të jetë gjithënjë; por do jetë një luftë naturale inteligjencash e jo lufta artificiale që shoqëria e soçme hap midis popujvet; se luftat e soçme bëjnë një seleksion së prapthi, mbasi çojnë në kasapanë të rinjtë e shëndoshë e kursejnë rreziqet e të dobtëve dhe të sëmurëve; bien më të mirët e mbeten më të dobtët. Lufta që popujt shtyhen të bëjnë nuk mund të quhet seleksion natural e është në dëm të evolucionit përparimtar.

Si duket ky është material për grupet simpatizante, ose grupet edukative të Partisë.

E DASHUR VATËR!

Porsi një flutur, e cila sado që të fluturojë e të endet në ajër, prapseprapë kthehet e qëndron mbi një lule, kështu edhe unë pas një largimi prej më se një muaji kthehem në gjirin tënd, o e dashur Vatër.

Kaloja dje ndëpër kopsht; bukuri pa fund, kudo lulëzim, kudo çfaqesh gjëzimi i këndëshëm prandveror. Pa dashur, i tërhequr prej një fuqije të pashpjeguar shme iu afrova e e këputa një zambak të freskët; sa shijë ndjenin hundët e mijë kur përkëdheleshin nga era e ballsamosur me aroma lulesh!

Nga ana tjeter shihja një djalë të vogël duke kënduar *vatrën* tonë; sa gjëzim ndjente ai djalë kur këndonte atë Vatër që përpinqet me mish e me shpirt përnë! Sikurse hundët e mijë kishin nevojë për erëra lulesh, ashtu edhe mëndja e ime kërkonte një zambak përt'u dëfryer e për të përfituar edhe ajo, e ky zambak je ti, o Vatër e dashur, që ushqen për ne një dashuri nënore. E atëhere vij përsëri tek ti, o Vatër, duke kërkuar drithë! . . .

*Besniku
Kristaq M. Tutulani*

*Botuar për herë të parë në
“VATRA E RINISE”,
qershori vitit 1934*

DUAJENI PUNËTORIN!

Shokë e shoqe të dashura,
Sot, sado që jam shok i juaj, po ju dërgoj një kë-
shillë aqë njerëzore sa edhe të virthytëshme:

«Duajeni punëtorin!»

Cili ësht ai që me shpërblimin më të vogël bën
punën më të rëndë? Cili është ai njeri që ju ndihmon
më tepër në jetën tuaj? Cili është ai që ju bën të gjëzo-
heni? Cili është ai që ju fal sendet e duhura pér rroj-
tje të mirë?

Natyrisht punëtori

Cili ngrihet që në mëngjes herët, pa dalë ende die-
lli, e, më mes të mjegullës e të errësirës, midis erës dhe
shiut, me duar të plasura prej morthi, duke shkelur
me këmbët e tij të zbathura mbi baltën e ngrirë, mbleth
ullinjt tuaj?

Pa fjalë punëtori.

Cili mbylljet orë të tëra ndën atmosferën mbytëse
të fabrikave? Cili hyn thellë në minierat e nënëdhesh-
me? Cili kalon natën pothuajse pa gjumë pér ju?

Askush tjetër përveç punëtorit.

Ju banoni në shtëpin tuaj të mirë, të mbrojtur nga
çdo e ligë, por a ju bie ndërmend kush ju fali një shtë-
pi të tillë? Kush në rrëzik jete punoi muaj me radhë
mbi ata mure që ndalojnë erën e shiun që t'ju dëmtojë?
Kush, me pagesën më të vogël, jua bëri këtë shtëpi
kaqë të bukur?

Pa dyshim një punëtor që banon në një kalibe përdhëske, me lagështirë e me rrëziqe.

Ju visheni mirë, por a mendoni njëherë që dikuash:

*Është përjashta fatziu,
E rreh breshëri, e rreh shiu,*

për të ruajtur ato dhen, që dhanë leshin e tyre për të bërë rrrobet t'uaja? A mendoni, që një plak i mjerë ka shpenzuar të gjitha fuqitë e pakëta që i jep një ushqim i paktë, për të mbjellur e për të korrur pambukun që mbajnë rrrobet tuaja? A mendoni se bariu e bujku, dy punëtorët më të vlefshëm, kanë fëmijët e tyre të veshur me lecka, që mezi i mprojnë nga rrezet përvëluese të korrikut e nga të ftohit mizor të janarit?

Me sa gëzim rrini pranë vatrës e shtyni urat e zjarrit që të rritet flaka mbi kërçepat e drujvet! Por a kini menduar ndonjëherë se një njeri si ju është lodhur së ngjituri e së zbrituri në pyll për t'ju prurë një gomar dru, që t'ju ngrohi, kurse në familjen e tij ngrijënë së ftohti?

Prandaj duajeni punëtorin! Duajeni më tepër se çdo tjatër në botë, se edhe ai ju do. Duajini sidomos fëmijët e tij, se janë fatkeqë, ndonëse kanë prindër të mirë!

Nderojeni e respektojeni punëtorin që përpinqet me mish e me shpirt për ju! Nderojeni për vuajtjet e përpjekjet e tij. Respektojeni atë sikurse respektoni punën!

Merrni shëmbëll prej atij, se s'ka shëmbëll më të mirë se heroi i punës.

Shoku i juaj
Kristaq Tutulani

*Botuar në gazetën «PIONIERI»,
15 nëndor 1945*

E DASHURË MARGARITA!

Këtë rradhë të lamë ne 15 ditë pa letër, gjë që më dëndur e ke zakon t'a bësh ti. Me gjithë atë të kemi kujtuar, sidomos unë që po vij vërdallë nga një dhomë në tjetër, Dhimitri që përmënd gjithënë Toshen e tij dhe Toni që mbeti pa «sipër-marrësen e ushqimit», sikurse thotë Dhimitri. Po, edhe Toni. Ka ca ditë mëma i rrëfente një fustan nga të tut e ai lihte pér të rrëfyer me një farë mënyre... mallin e vet.

Ua mblođhi rripat ca ai qerrata lyce mikst simvjet! S'është shaka, duhet punë. Pastaj në klasat t'uaja ka nxënës të zotët më duket; me ç'njoh unë, ca Kuqalër, ca Koljaka e Pogonër. Duhet të mos të të kalojnë, sidomos në shqipe e italishte, prandaj këndo copa nga shkrimtarët e ndryshém të letërsisë që të kesh formuar që më parë një ide pér seicilin prej tyre; kur t'i bësh mësim t'i njohësh mirë mendimet, stilin e vlerën letrare të tyre. E me matematikën?

Unë punoj në kopsht e leçis fare pakë. «Furore» më pëlqeu shumë. Kam lexuar ca copa nga një trajtim; «Antropologia delle classi povere» me rendësi shkencore si në mjeksi ashtu edhe në pikëpamje psikologjike e shoqërore. Këndova edhe ca nga Nietzscheja, por nuk jam bërë Nietzchian. Përbledhja e Darvinit thuajse mbeti, mbasi gjenj vështirësira të mëdha. Novelën tënde them t'a daktillografonj e t'ja dërgoj konkursit të të rinjvet me pseudonimin Rita. Do të mendohem. Të fala të njohurvet.

Të përqafoj
Kristaq

Berat, 21 Shtator 1941

Firence më 30 të Marsit 1942

Fort i dashur Zisa!

Përse ta vonova përgjigjen, këtë do të ta thotë Miti i cili, dembel Stambolli, harron të më shkruaj pak radhë.

Jam i kënaqur që në këtë vështirësi që kalova përzgjedhjen, sa do që nuk të qeshi fati, nuk e humbe zémrrën e vërvitesh në betejë me guxim. Zemër, se fati u ndih guximtarëve. Më pëlqen ekspozeja që më bën pér arësyet pér të cilat preferon letrat. Natyrishët ti më njeh dhe e di se mua më bëhet zemra mal, kur vë re se nuk janë arësyte inerente me veten tënde, por me karakter më fort shoqëror e patriotik. Sido qoftë mendimi im është që mjekësia ndër ne është aqë e dobishme e ideale sa ajo lëfton sëmundjen e injorancës. Fakti qëndron se ndaj kësaj të fundit ti ndiheshe më i prirur se sa ndaj së parës: e ndjen veten më të sigurt pér ngadhënjim kur je i armatosur me librin se sa me nishterin, kur ke përpëra analfabetizmin se sa malarjen, më fort ushtar i Kryqëzatës së dritës se sa, i asaj të shënditetit, dhe pér shoqërinë është më mirë që secili të jetë në vëndin e vet. Pastaj egoistikisht të ka më fort shije lufta e parë se sa lufta e dytë, jo vetëm pér sigurinë e fitimit më të math në njerin rast se sa në tjetrin, por edhe pér ndjenjën që në njerin rast i shtonhet armës së kulturës pér vokasionin, pér të përdorur një fjalë tanë më të rradhës së parë në këtë fushë. Por kjo jetë na ruan shumë tallaze e shpesh nga njera rrugë na hedh në një tjetër, më të shëmtuar që na lodh më fort. Por trimi i mirë e ndjek edhe këtë rrugë, mjaft të arrijë një qëllim: të jetë i vlefshëm në maksimumin

e mundëshëm e të kënaqë, kësisoj, nevojën që ka çdo njeri me ndjenja.

Ndërkaq, në se do të jap të gjitha provimet tani, gjë që mjerishtështë e zorëshme ca, do të shkruhem mësues vullnetar përmuajt e verës në Kosovë. Po të mundesh, e bëjmë këtë gjë së bashku; s'ka gjë më ideale se sa të mbjellësh dritën aty ku si shpendër e egër qëndron analafabetizma: natyrisht nuk është fjala «*të gatuajmë një trupore të re nga balta e njomë*», pse do të kemi të bëjmë me burra të thinjur; por a nuk është një kuadër i bukur ky? Njëzet e dyzet burra të pjekur me plot kryqe lufte të jetës që ndjekin me vëmëndje e me vështirësi një djalë i cili u hap horizonte të reja si në një përrallë.

Për bursën time si duket puna, nuk u bë gjë. Unë nuk di kurrgjë: se sa bursa jepen, cilat janë konditat e konkursit etj. Vetëm im gjysh më shkroi një herë se kish përgatitur dokumentat e lutjen e i kish qituri këtë lypesh. Pastaj heshtje e plotë. Dëndur i kam shkruar, e kam pyetur mbi përfundimin: nuk ma ka zënë ngojesh fare këtë punë. Mësimet kam shpresë t'i arrij në këto pushime. Që nesër po filloj një punë më të rregulltë e më sistematike.

Kam qejf të bëj një shëtitje andej nga Bolonja juaj zhurmëmadhe; do të jem si katundari që zbret në qytet se Firencja për fat të keq ose të mirë gëzon një qetësi fshati. Uroju nga ana ime, të lutem, për shumë vjet e nga mot gëzuar Pashkët, Mitit, Paskalit, Lekos e gjithë atyre që njef aty me emër e me fytyrë. T'uroj edhe ty festa të gëzuara e të përqafoj.

Kristaq

Mos harro të bësh nga ana e ime urimet për gjitha që njof aty, sepse s'kam se si t'i uroj një nga një, mbasi jo vetëm puna vete gjatë por edhe me të shumtë-vet nuk ua kam drejtimin.

Zisa i dashur!

Po të përgjigjem me vonesë, se kam dashur të vëzhgoj mirë për punën tënde, me shpresë të të kënaqja. Për fat të keq nuk kam veçse të të lajmëroj që në këto anë, dorë për dorë nuk mbetet asnje shpresë po-thuaj. Në letërsi janë vetëm tri vajza hundëpërpjeta dhe, pa fjalë, me to s'u bë dot gjë. Më së fundi ma dhanë, pas kaq nazesh, përgjigjen e fundit se nuk duan të këmbejnë fakultetin. Uroj që të gjesh, në ndonjë tjetër qytet, ndonjë që të pronojë, sa do që do të më pëlqente që këtë fat ta kisha unë e të të kënaqja.

Për mua t'isha bursist në letra e të më propozohesh në mjekësi, do të pranonja me njëherë si do që t'ishin prirjet e mijë. Këtë s'e them se jam materialist. Nuk them sepse mjekësia si karrjerë është më e frytëshme se sa letërsia, sepse kënaqësia shpirtërore që gjen njeriu kur punon në fushën e tij e kapërxen avatashin material. Porse është një gjësënd, i dashur Zisa, dhe këtu nuk jam një avokat që kërkon të të mbushi mëndjen e as një shok që është mëshiruar dhe kërkon të të ngushëllojë. Po të shfaq mendimin tim singerisht: letërsia është një degë e bukur kur je diletant i sajë, kur si një flutur shkon e mbledh nektar lule më lule, për të përdorur një figurë sa të vjetër aqë edhe banale, por që të jesh profesionist i saj, që të studjoj filologji e gjuhë të vjetra, që të vrasësh çdo inspiratë e çdo shije të bukur me armën e gramatikës e të kritikës së thatë e shpirtkazmë, më duket një vetvrasje. Uroj që të përmbushet deshira e jote e t'ja dedikosh jetën veprave të bukura që shpirtëra të vuajtur e të ndijëshëm i kanë falur së bashku me jetën e tyre njerzisë së mjeruar. Por edhe në rast se nuk do të mundesh të arrijsh këtë qëllim, mund të ndjekësh letrat e bukura tamam si dile-

tant e të vijosh t'i bindesh muzës tënde duke qënë një-kohësishët edhe një mjek i mirë, profesion i vlefshëm për kolektivitetin dhe mjaft i këshillueshëm për pikë-pamje të tjera. Një pjesë e madhe e letrarëve të botës nuk kanë qenë profesorë, Dantja vetë i ka kushtuar një pjesë të madhe të jetës së tij politikës së qytetit. Prandaj vijo mëso me rregull mjekësinë, në rast se nuk arrin të këmbesh degën, munde idenë që po punon angari, kërko të zgjosh kureshtinë, jo vetëm për materjet e bukura si fiziologjia e biologjia, por edhe për anatominë e rëndë. Dhe të siguroj që nuk do të largohesh nga letrat edhe duke qënë një mjek.

Unë do të nis periudhën e punës, se deri tanë më është dashur të thyej inercien që më la një plogështi e plotë dy vjetëshe në Shqipëri. Firencja, tepër e qetë për mua që kisha nevojë për një jetë më të dëndur si një ilaç për sëmundjen time, lethargjinë, me gjith atë më pëlqen se në çdo kënd të saj shpesh herë më del përrpara një bukuri e harruar që s'e kam vënë re deri n'atë çast e që më zbulon befas një poezi vijash e ngjyrash, sipas rastit, kur është fjala për një kënd pallati a kopshët. Se Firencja, sidomos tanë në këtë avant-gout pranvere, është njëkohësishët një pallat elegant n'austeritetin e tij dhe një verandë lulesh e gjelbërimesh. Mjerisht nuk mundem të shof veprat më me vlerë, në këto kohë.

Nuk kam asnje copë nga të Migjenit (në Berat tanë i kam pothuaj të gjitha poezitë e këtij poeti), as edhe ndonjë libër tjetër.

Nuk di në do të rri gjith vitin këtu; për arësyte ekonomike. Por tanë jepen në Shqipëri disa bursa për drejtësi; diploma e ime është e mirë, një mesatare midis 8 1/2-9 kam, dhe kam shpresë të shkëpus një bursë. Në rast të tillë mund të qëndroj këtu. Në Shqipëri mund të mësoj njëlloj, por më pëlqen të rri këtu se kam këshfu mundësi të ndjek koncerete, shfaqje, dhe konferanca që atje mungojnë, sidomos për Majin Fjorentin.

Të përqafoj
Kristaq

Shënim i redaksisë

Kjo është përbledhja e parë me shkrimet e zgjedhura të letrarit dëshmor Kristaq Tutulani që batohet.

Në përgatitjen e këtij libri është patur parasysh që të përmblidhen gjithë ato shkrime, të cilat i japin një ide të qartë lexonjësit për rrugën që ka përshkruar letrari dëshmor.

Eshtë bërë njëjsimi gjuhësor në bazë të ortografisë së sotme dhe në ndonjë rast të rrallë është bërë edhe ndonjë ndryshim i vogël, po gjithmonë duke ruajtur karakteristikat e gjuhës dhe stilit të autorit.

Pjesët që nuk kanë të shenuar datën e botimit ruhen në dorëshkrime pranë A. Q. PPSH.

PASQYRA E LËNDËS

V a r g j e

	Faqe
Shqipërisë	11
Lamtumirë, dallëndyshe!	13
U thanë gjethet	15
Valle zanash.	16
Për pârvjetorin e «Vatrës së Rinisë».	17
Si ikin vjetët	18
Kujtim i foshnjërisë, këndona!	20
As eja frymëzim!	23
Etje për vetmi	25
Sot, vëlla, q'ështëjeta?	27
Porse një kasolle	29
Shokut tim S. A.	30
Një këngë.	32
Rruga është e bardhë.	34
Ephsh.	36
Shtegtar	39
A blehet me flori?	41
Do ta mbyll në gjë	42
E ka djali.	43
Thuajma, thuajma mua.	45

Përshkrime, skica dhe novelëza

Mall për atdhe.	49
Atdheu.	50
Kujtim dhjetori.	51
Tue shikue rrugën	54
Pranvera.	57
Pashë.	59
Kur.	60
Këndomë, motër!	61
Pashë një èndër	63

32312
SHËNIME MBI ARTIM DHE LETËRSINË
DURXHËMË

Faqe

Tha Perendia	64
Zemra e atdhetarit	66
26 prill 1451.	70
17 janar 1467.	73
Përqafim.	76
Ditë vere.	79
Llambi.	84
Nuria.	87
Stinë të qeta.	90

Shënime mbi artim dhe letërsinë

Migjeni.	93
Poezia popullore — poetët anonimë.	95

Artikuj, biseda, fjalime, letra

Maji i luleve, gjaku i solidaritetit proletarian.	105
Q'është mbledhja edukative?	108
Partia Komuniste.	112
Gruaja në të ardhëshmen.	113
Vdekje fashizmit — Liri popullit!	114
Darvini.	116
E dashur Vatër!	122
Duajeni punëtorin!	123
E dashura Margarita!	125
Fort i dashur Zisa!	126
Zisa i dashur!	128